



# USHTRIA



Viti i 73-të i botimit Nr. 30 (827677)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 31 korrik 2020

## Modernizimi i Emergjencave Civile



### Turqia dhuron 1250 uniforma të reja për Emergjencat Civile

Strukturat e Emergjencave Civile, pjesë e Forcave të Armatosura do të jenë shumë herë më të mirëpajisura dhe më dinjitoze në përballimin e fatkeqësive natyrore. 1250 uniforma të reja, të cilat përmbushin të gjitha standardet e sigurisë, u dhuruan nga qeveria turke për Forcat tona të Armatosura. Të pranishëm

në këtë ceremoni ishin Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë, Olta Xhaçka, ambasadori i Turqisë në Tiranë, Murat Ahmet Yoruk si dhe drejtues të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka shprehu ditën e martë, më 28 korrik 2020, falënderimet më të thella për popullin dhe qeverinë... >>> faqe 3

Presidenti i Republikës, z.Illir Meta, dekreton :

## Gjeneral major Bajram Bega, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH



>>> faqe 3

## Shefi i FSK, Gjenerallejtënant Rrahman Rama në Tiranë Kollçaku-Rama: Të intensifikohet plani i bashkëpunimit ushtarak midis FARSH-së dhe FSK-së

Ne kemi shumë mundësi për të ngritur, zgjeruar dhe thelluar bashkëpunimin tonë ushtarak në nivele akoma më të larta, duke rritur implementimin e planeve të dakordësuara >>> faqe 2



## Projekti "TO BE READY"

### Projekt në fushën e mbrojtjes civile dhe administrimit të rrezikut

Projekti "TO BE READY-The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst and Emergency management", financohet në kuadër të thirrjes tematike të Programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi. Projekti me vlerë 5.009.633.49 Euro ka filluar në shtator 2019 dhe do të zgjasë deri në qershor 2022. Projekti, i udhëhequr nga rajoni i Molises, përfshin partneritetin e autoriteteve...



>>> faqe 5

## Qendra Stërvitore Kuçovë

### Përfundon Kursi Bazë i Avancuar i Nënoficerit

Në Qendrën Stërvitore të Kuçovës u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë dhe të Avancuar të Nënoficerit. Në këtë ceremoni mori pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Editsen Zarka. Kolonel Zarka në fjalën tij përgëzoi drejtuesit e qendrës për përkushtimin dhe punën e bërë gjatë periudhës së COVID-19, për përgatitjen profesionale të kursantëve, ndërsa personelit... >>> faqe 6

### Qendra për Studime Euro-Atlantike në Serbi

## Java e NATO-s në Beograd

>>> faqe 9

PROCEDURAT E REKRUTIMIT PËR OFICERË

### "Bachelor" në Shkenca Ushtarake në Akademinë e Forcave të Armatosura

faqe 4

AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA

### Viti akademik 2020-2021, aplikoni për 60 të drejta studimi

faqe 7



Shefi i FSK, Gjeneralletenant Rrahman Rama në Tiranë

# Kollçaku-Rama: Të intensifikohet plani i bashkëpunimit ushtarak midis FARSH-së dhe FSK-së

*Ne kemi shumë mundësi për të ngritur, zgjeruar dhe thelluar bashkëpunimin tonë ushtarak në nivele akoma më të larta, duke rritur implementimin e planeve të dakordësuara*

**M**e ftesë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjeneralletenant Rrahman Rama zhvilloi më 23 korrik 2020, një vizitë zyrtare në Tiranë. Kjo vizitë është realizuar në kuadër të planit të bashkëpunimit ushtarak dypalësh midis FSK dhe FARSH.

Agjendën e tij, gjeneral Rama me delegacionin shoqërues e filloi me vizitën në Ministrinë e Mbrojtjes, ku me ceremoni dhe nderimet më të larta ushtarake u prit nga homologu i tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku shoqëruar nga stafi i tij më i lartë. Në Ministrinë e Mbrojtjes, gjeneral Rama, takimin e parë e zhvilloi me zëvendësministrin e Mbrojtjes, Petro Koçi dhe stafin e tij. Në fillim, zëvendësministri Koçi e njoftoi gjeneral Ramën me zhvillimet kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, vlerësimin e lartë të nivelit të bashkëpunimit ndërministror dhe ndërshtrik me zotimin për thellim dhe zgjerim të mëtejshëm të këtij bashkëpunimi. Duke shprehur falënderimin për ftesën dhe pritjen vëllazërore, gjeneral Rama vlerësoi lart mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe instancat tjera shtetërore për mbështetjen e deritashme në të gjitha aspektet me theks të veçantë në aspektin e diplomacisë ushtarake, ku si vend anëtare e NATO-s, Kartës së Adriatikut (A5) dhe iniciativave rajonale të sigurisë dhe mbrojtjes, ka ndikuar shumë në fuqizimin e pozicionit të ministrisë sonë dhe FSK-së në strukturat përkatëse.

Pastaj, gjeneral Rama, pas pritjes me ceremoni nderi, zhvilloi takimin me homologun e tij me gjeneral Kollçakun. Në fillim të takimit, të dy gjeneralët informuan njëri-tjetrin lidhur me zhvillimet e përgjithshme aktuale të forcave, sfidave aktuale të shkaktuara nga kriza e pandemisë COVID-19 si dhe objektivat zhvillimor për të ardhmen. Pastaj fokusi i takimit në mes të dy delegacioneve respektive ishte në çështjet kryesore me interes të përbashkët, respektivisht vlerësimin e shkallës së realizimit të planit të bashkëpunimit ushtarak dypalësh FSK-FARSH, aktivitetet në proces të realizimit si dhe ato të planifikuara për të ardhmen. Gjeneral Rama shprehur mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për mbështetjen e deritashme në të gjitha fushat të FARSH për FSK-në duke shprehur gatishmërinë për vazhdimin e ofrimit të mbështetjes së ndërsjellë nga ana e FSK-së në fushat që vlerësohen nga ana e FARSH-së. Nga ana e tij, gjeneral Kollçaku, çmoi lart të arriturat e deritashme të FSK-së me theks të veçantë në aspektin e profe-



sionalizimit të burimeve njerëzore dhe shkallës së operacionalitetit të gjitha këto të dëshmuara me sukseset e larta në të gjitha nivelet arsimore-stërvitore të përbashkëta në kuadër të akademive dhe stërvitjeve shumëkombëshe, si dhe në operacionet e realizuara.

“Dua të shpreh një falenderim të veçantë për kontributin dhe ndihmën e pakursyer të burrave dhe grave të FSK gjatë tërmetit të nëntorit të vitit të kaluar, si dhe mbështetjen e pamatë dhe shumë bujare për arsimimin e ushtarakëve tanë në Kosovë. Pavarësisht nivelit të shkëlqyer të bashkëpunimit ushtarak, unë besoj dhe jam i sigurt, ashtu sikurse u shprehët edhe ju, që ne kemi shumë mundësi për të ngritur, zgjeruar dhe thelluar këtë bashkëpunim në nivele akoma më të larta, duke rritur ritmin e implementimit të planeve konkrete të dakordësuara”, - u shpreh ndër të tjera gjeneral brigade Kollçaku gjatë takimit.

Në fund të dy u dakorduan për intensifikimin e bashkëpunimit në nivel të mbështetjes së ndërsjellë dhe në nivel të shkëmbimeve të eksperiencave, aftësive dhe kapaciteteve në fushat me interes të përbashkët.

Gjatë takimit gjeneral Kollçaku shoqërohej nga drejtori i Drejtorisë

së Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes (J-5/8), kolonel Bilbil Bitri, drejtor i kabinetit të tij, Kolonel Arben Zani, oficeri i J5/8, nënkolonel Fredi Maksuti dhe këshilltari i tij politik,

Perikli Koliqi. Gjatë vizitës dhe takimeve gjeneral Rama u shoqërua nga delegacioni i përbërë prej atashut të Mbrojtjes së Republikës së Kosovës në Republikën e Shqipërisë, kolonel

Bashkim Shillova, këshilltari ushtarak, nënkolonel Berat Shala, zyrtar i politikës dhe marrëdhënie ndërinstitucionale, Ali Bajqinovci si dhe asistentes ushtarake, kapiten Manushaqe Nura.

## Presidenti Ilir Meta pret gjeneralletenant Rrahman Rama

**G**jatë vizitës zyrtare në Tiranë, gjeneralletenant Rrahman Rama është pritur në një takim të veçantë, nga presidenti i Republikës së Shqipërisë, njëkohësisht Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, shkëlqesia e tij Ilir Meta i cili shprehur edhe njëherë admirimin e madh për FSK-në dhe besimin e plotë për perspektivën zhvillimore të saj të afërt në strukturat operationale të NATO-s në misionet paqeruajtëse duke fuqizuar rolin e Kosovës në funksion të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal e më gjerë.

Gjeneral Rama i ritheksoi mirënjohjen dhe falënderimin Presidentit Meta për mbështetjen e tij të pandërprerë në të gjitha etapat e zhvillimit të forcave ushtarake të vendit nga të gjitha pozitat e tij të lidhshme shtetërore dhe besimin e plotë në rolin dhe angazhimin e njëjtë për FSK-në edhe në të ardhmen. Për këtë arsye edhe simbolikisht i dhuroi uniformën kamuflazh të FSK-së.



STAFI

**DED KOLA**  
Shef i Sektorit të  
Botimeve & Kryeredaktor

**Gazetarë:**  
Mimoza **GOLIKJA**

**Gazetarë:**  
Saimir **ALIJA**

**Graphic Designer:**  
Afërdita **HYSAJ**

**ADRESA:**  
Rruga e Dibrës/  
Garnizoni "Skënderbej"

# Modernizimi i Emergjencave Civile

## Turqia dhuron 1250 uniforma të reja për Emergjencat Civile

*Marrëdhëniet e bashkëpunimit ushtarak përbëjnë një nga dimensionet më të rëndësishme të marrëdhënieve të veçanta të Republikës së Turqisë dhe Republikës së Shqipërisë*

Strukturat e Emergjencave Civile, pjesë e Forcave të Armatosura do të jenë shumë herë më të mirëpajisura dhe më dinjitoze në përballimin e fatkeqësive natyrore. 1250 uniforma të reja, të cilat përbushin të gjitha standardet e sigurisë, u dhuruan nga qeveria turke për Forcat tona të Armatosura. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin Ministrija e Mbrojtjes e Shqipërisë, Olta Xhaçka, ambasadori i Turqisë në Tiranë, Murat Ahmet Yoruk si dhe drejtues të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Ministrija e Mbrojtjes Olta Xhaçka shprehu ditën e martë, më 28 korrik 2020, falënderimet më të thella për popullin dhe qeverinë turke, duke cituar edhe shprehjen "miku i mirë në kohë të vështira". Duke përmendur investimet e viteve të fundit në Forcat e Armatosura, ministrija Xhaçka theksoi vëmendjen që është dhënë modernizimit dhe riorganizimit të strukturave të Emergjencave Civile.

"Brenda pak ditësh mbushet plot një vit që nga momenti kur Kuvendi miratoi ligji për mbrojtjen civile, i cili solli një revolucion të vërtetë në formën e organizimit, në rritjen e kapaciteteve dhe profesionalizmit, dhe në aftësinë tonë për të përballuar emergjencat. Sot, kur nuk është mbushur ende viti nga fillimi i punës për ngritjen e kësaj strukture kaq të rëndësishme, e them me krenari që ia kemi dalë të ngremë një strukturë të vërtetë efektive, por ç'është më e rëndësishmja, edhe të pajisur me mjete nga më modernet e profesionale." - u shpreh zonja Xhaçka, e cila njoftoi pajisjen e mëtijshme të Emergjencave Civile, falë bujarisë së qeverisë turke. "Shumë punë është bërë edhe për rritjen e kapaciteteve në përballimin e emergjencave. Dhe miratimi i projektligjit do t'i hapë rrugë përthithjes së një fondi prej 2,3 milionë dollarësh, faza e dytë e grantit turk, për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga Ministria e Mbrojtjes. Sepse ashtu si në fazën e parë të grantit të akorduar nga Turqia për Ministrinë e Mbrojtjes edhe ky fond do të përdoret në funksion të përballimit të emergjencave civile me të cilat përballet vendi." "Duke filluar me 6 ambulancat moderne, që janë në fakt mini spitale lëvizëse të pajisura me të gjitha pajisjet e nevojshme, që nga respiratorët, kompletet e imobilizimit për frakturat apo edhe shumë aparatura të tjera për ndihmë të parë të specializuar, të adhurua nga Turqia", - theksoi Xhaçka e cila shtoi se: "Duke vazhduar me rritjen e kapaciteteve për shuarjen e zjarreve, pajisjet për heqjen e ujërave pas përmbytjeve, mbi 100 çadra me sipërfaqe nga 25 deri në 100 metra katrorë, e deri tek 1250 uniformat e reja të brenduara me logon e Forcave të Armatosura dhe Emergjencat Civile, nga ku 500 palë uniforma të posaçme kundër shiut, 400 palë kundër zjarreve në pyje, që janë një nga sfidat tona të përvitshme, 250 palë uniforma kërkim shpëtimi dhe 100 uniforma për zjarrfikës profesionistë".

Ambasadori i Turqisë në vendin tonë Murat Ahmet Yoruk, vlerësoi marrëdhëniet mes dy popujve dhe nënvizoi se vlera e mjeteve, pajisjeve dhe uniformave të reja të dhuruara nga



qeveria turke arrin në 1,5 milionë dollarë amerikanë.

"Menjëherë pas tërmeteve në muajt shtator dhe nëntor të vitit të kaluar dhe gjatë pandemisë së COVID-19, me udhëzime të Presidentit tonë të gjithë institucionet përkatëse u vunë në

gadishmëri dhe u nxituan për të ndihmuar vëllezërit tanë shqiptarë. Qoftë me pjesëmarrjen e ekipeve të kërkim shpëtimi që operuan direkt në terren, qoftë edhe me qendrën e menaxhimit të emergjencave të fatkeqësive natyrore, Ministrisë së Shëndetësisë, Agjencinë

TIKA dhe Gjysëm Hënës së Kuqe, ne kemi nxituar për të ofruar ndihmat më imediate dhe njëkohësisht për të mjekuar sado pak plagët e shkakutara", - tha Yoruk.

Duke folur për marrëdhëniet e bashkëpunimit ushtarak mes dy

vendeve, ambasadori Yoruk theksoi: "Marrëdhëniet e bashkëpunimit ushtarak përbëjnë një nga dimensionet më të rëndësishme të marrëdhënieve të veçanta të Republikës së Turqisë dhe Republikës së Shqipërisë. Në sajë të marrëveshjes së bashkëpunimit financiar ushtarak, ne që prej afro 25 vitesh arrijmë të ofrojmë kontributin tonë për Forcat e Armatosura Shqiptare, aleates tonë në NATO".

"Njëkohësisht ne vazhdojmë punën dhe bashkëpunimin me Ministrinë e Mbrojtjes për të bërë të mundur rritjen e kapaciteteve të forcave civile në një afat të mesëm dhe afat të gjatë. Në këtë kontekst ne sot i dorëzojmë vëllezërve shqiptarë 6 autoambulanca tërësisht të kompletuara, 400 uniforma zjarrfikse, 500 uniforma që do të përdoren gjatë operacioneve të fatkeqësive natyrore të përmbytjeve, 100 uniforma speciale zjarrfikse, 250 uniforma të ndryshme për kërkim shpëtimi dhe 160 çadra të llojeve të ndryshme. Vlera e të gjithë këtyre materialeve dhe pajisjeve kap shifrën 1,5 milionë dollarë", - përfundoi Yoruk.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS, Z.ILIR META, DEKRETON:

## Gjeneral major Bajram Bega, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Z. Ilir Meta, me dekret Nr.11527, datë 29 korrik 2020 ka dekretuar sot emërimin e gjeneralmajor Bajram Begës, shef të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH. Dekreti, si më poshtë vijon: "Në mbështetje të nenit 93 dhe pikës 3, të nenit 169, të Kushtetutës, të shkronjës "b", të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr.64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin nr. prot.. 3830/1, datë 29.07.2020 të kryeministrit, Dekretoj: Gjeneralmajor Bajram Rushit Begaj, me detyrë komandant Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, emërohet shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Gjeneral Major Bajram Begaj, ka lindur në datë 20.03.1967, në Rrogozhinë. Ka përfunduar studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Degën Mjekësi e Përgjithshme në vitin 1989 dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin "Mjekësi" në vitin 1998. Ai gjithashtu ka përfunduar "Doktoraturën në Fushën e Mjekësisë", ndërsa mban edhe titullin "Profesor i Asociuar" në Mjekësi. Gjatë karrierës së tij



ushtarake ka kryer: "Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen", në Shqipëri; "Shkollën e thelluar pasuniversitare të mjekësisë", në Shqipëri; "Specializimin Pasuniversitar në profilin Gastrohepatologji", në Shqipëri; "Kursin e menaxhimit spitalor" dhe "Kursin e lidhshimit mjekësor strategjik", në SHBA; "Specializimin në fushën e mjekësisë" dhe "Kursin e Shëndetësisë", në Greqi. Ai ka kryer detyra të ndryshme si: Shef i Njësisë Mjekësore Ushtarake dhe Zëvendës Drejtor Ushtarak i SUT, Drejtor i Spitalit Ushtarak, etj. Aktualisht, ishte në detyrën e Komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (SHSHPFA) është detyra më e lartë ushtarake në FA. Mandati i tij është 3-vjeçar dhe emërohet me dekret të presidentit të Republikës, me propozim të kryeministrit. Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA në vitin 2017. Gjeneralmajor Bajram Begaj i dekretuar si shefi i ri i Shtabit të Përgjithshëm të FA, mbante detyrën e Komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

## PROCEDURAT E REKRUTIMIT PËR OFICERË

# “Bachelor” në Shkenca Ushtarake në Akademinë e Forcave të Armatosura

*Për vitin akademik 2020-2021 do rekrutohen 60 kandidatë për oficerë, për të ndjekur studimet në ciklin e parë “Bachelor” në Shkenca Ushtarake*

Akademia e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2020-2021 do të rekrutojë 60 (gjashtëdhjetë) kandidatë për oficerë, për të ndjekur studimet në ciklin e parë “Bachelor” në Shkenca Ushtarake.

## Kriteret e pranimit të kandidatëve

Pranimi në programin e studimit “Bachelor” në Shkenca Ushtarake është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pranimi i kandidatëve bëhet me konkurrim, ku 60% të vlerësimit e zë rezultati i konkurimit dhe 40% e zë rezultati i maturës shtetërore. Për t’u pranuar në këtë cikël studimi, aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta si më poshtë:

### Kritere të përgjithshme:

të ketë shtetësi shqiptare; të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës së Shqipërisë; të mos jete i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë; të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 22 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik.

### Kritere të veçanta:

Të jetë i aftë nga ana shëndetësore; të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 për femrat; të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm pa mangësi apo shenja që deformojnë pamjen e jashtme; të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (semundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga semundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatiche, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i levizjes) apo të ketë qenë ose të jetë përdorues i lëndëve narkotike; e) të mos jetë i martuar. Kandidati që nuk plotëson kriteret e përcaktuara më sipër skualifikohet.

### Procedurat e aplikimit dhe konkurimit

Kandidatët që rezultojnë fitues nga konkurrimi në portal [www.ualbania.al](http://www.ualbania.al) (matura shtetërore) për ndjekjen e programit “Bachelor” në Shkenca Ushtarake, paraqiten personalisht pranë Sekretarisë Mësimore të Akademisë së Forcave të Armatosura ku plotësojnë formularin e aplikimit për këtë program, si dhe paraqesin dokumentacionin përkatës. Kandidatët e regjistruar i nënshtrohen procesit të testimit i cili konsiston: Ekzaminimin e gjendjes shëndetësore; Testim fizik; Intervistë; Procesii i tes-



timit organizohet dhe drejtohet nga Komisioni ad hoc, bazuar në këtë rregullore dhe sipas vendimeve të autoriteteve drejtuese të këtij programi. Ky proces do të zhvillohet sipas parimit të mosdiskriminimit dhe të vlerësimit objektiv dhe të drejtës për aplikim, duke vlerësuar në mënyrë të paanshme të gjithë dokumentacionin e paraqitur dhe duke motivuar të gjitha rastet e mospranimit në këtë program studimi.

Shpallen fitues kandidatët që janë vlerësuar me numrin maksimal të pikëve në rend zbritës, deri në plotësimin e kuotës së parashikuar të pranimit. Kjo kuotë bëhet publike që në fillimin e aplikimeve.

Kandidati fiton të drejtën për të filluar studimet në Akademinë e Forcave të Armatosura në programin e studimit “Bachelor” në Shkenca Ushtarake, kur regjistrohet në Sekretarinë Mësimore të fakultetit sipas udhëzimeve të dhëna nga MASR, në të kundërt, ai humbet të drejtën për ndjekjen e studimeve në AFA.

Lista e kandidatëve fitues për programin “Bachelor”, shpallet në mjedise të dukshme në Akademinë e Forcave të Armatosura, websitin zyrtar të saj ([www.tradoc.mil.al](http://www.tradoc.mil.al)) dhe Ministrisë së Mbrojtjes ([www.mbrojtja.gov.al](http://www.mbrojtja.gov.al)). Kandidatët që nuk shpallen fitues, kanë të drejtën e ankimit në Akademinë e Forcave të Armatosura, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. Rektori jep përgjigje të motivuar, në formë të shkruar, brenda 7 ditëve nga paraqitja e ankesës. Kandidati që nuk ka fituar mund të konkurrojë përsëri në vitin pasardhës.

### Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidatët që do të rekrutohen për të ndjekur studimet në ciklin e parë “Bachelor” në “Shkenca Ushtarake” në Akademinë e Forcave të Armatosura, dhe rezultojnë fitues nga matura shtetërore, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: Në fazën e regjistrimit a) kërkesë me shkrim për ndjekjen e studimeve ushtarake; b) formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A, bashkëlidhur këtij dokumenti; c) formular i vetëdeklarimit për gjendjen shëndetësore i cili plotësohet pranë AFA-së në momentin e dorëz-

imit të dokumentacionit. d) fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimimit përkatës së bashku me listen e notave; e) fotokopje e kartës së identitetit; f) certifikatë familjare, 1 copë; g) fotografi për dokument (4x6), 2 copë; h) raportin mjekoligjor të lëshuar nga Komisioni Mjekoligjor i Qendrës Shëndetësore të vendbanimit; i) analizat e gjakut për Hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publikë në rrethet ku banojnë.

Në përfundim të konkurimit a) dëshmi penaliteti; b) vërtetim nga përbarimi; c) vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor; d) vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi.

### Periudha e konkurimit

Afatet e konkurimit janë të përcaktuara në urdhrin e përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) nr. 02 datë 02.07.2020 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programin e ciklit të parë të studimeve, në programet e integruara të studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të dytë të studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2020-2021”.

Shënim: Personi që aplikon deklaron se të dhënat e paraqitura në formularë përkatës janë të vërteta dhe autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe pas sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme.



## PROJEKTI "TO BE READY"

# Projekt në fushën e mbrojtjes civile dhe administrimit të rrezikut

*Projekti si financim i BE-së, me vlerë 5 milionë euro, pjesë e Programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri -Mali i Zi përfundon në qershor 2022*

Projekti "TO BE READY-The flood and Big fire for Emergency prediction, forecast and emergency management", financohet në kuadër të thirrjes tematike të Programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi. Projekti me vlerë 5.009.633.49 Euro ka filluar në shtator 2019 dhe do të zgjasë deri në qershor 2022

Projekti, i udhëhequr nga rajoni i Molises, përfshin partneritetin e autoriteteve kryesore kompetente në fushën e mbrojtjes civile dhe administrimit të rrezikut, të cilat kanë përvojë dhe ekspertizë në kërkimin, analizën dhe menaxhimin e riskut. Ky partneritet do të jetë në gjendje të zhvillojë strategjitë më të mira në përmirësimin e kushteve me qëllim rritjen e parrezikshmërisë nga katastrofat natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut të basenit italian, shqiptar dhe malazez, duke vënë në zbatim iniciativa ndërkufitare të afta të krijojnë një urë midis rajoneve pjesëmarrëse në mënyrë që të adoptohen strategji të koordinuara bashkërisht për ndërhyrje në raste zjarresh dhe përmbajtjes.

Qasja ndërkufitare, përfaqëson një vlerë të shtuar për projektin dhe ka të bëjë me veçoritë e ndryshme të territoreve të përfshira dhe me mënyrat e ndryshme të parandalimit dhe ndërhyrjes në rast të zjarreve, ose përmbajtjeve, të cilat të integruara, sigurisht që do të kontribuojnë në zhvillimin e një modeli operativ të suksesshëm. Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian përmes Instrumentit të Para-anëtarësimit (IPA II). Shoqëria partnere: Rajoni Molises-Leader.

Partnerët e projektit: Rajoni Molise-Departamenti i Mbrojtjes Civile; Rajoni Puglia- Departamenti i Mbrojtjes Civile; Ministria e Brendshme e Malit të Zi-Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave; Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë-Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Kurse Partnerët e asociuar janë Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Shqipërisë - Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit nga Zjarri.

Aktivitetet e projektit bazohen në tre nga katër shtyllat themelore të sistemit të mbrojtjes civile: Parashikimi i emergjencës, parandalimi dhe menaxhimi.

Projekti synon të lëshojë një sfidë të përbashkët ndërmjet zonës së detit Adriatik të Italisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi, zona, që vitet e fundit, janë prekur nga fatkeqësi të ndryshme natyrore si edhe të shkaktuara nga dora e njeriut, me vëmendje të veçantë ndaj rrezikut të zjarreve në pyje dhe atij të përmbajtjeve.

Partneriteti do të jetë në gjendje të zhvillojë strategjitë më të mira në përmirësimin e kushteve me qëllim rritjen e parrezikshmërisë nga katastrofat natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut të basenit italian, shqiptar dhe malazez, duke vënë në zbatim iniciativa ndërkufitare të afta të krijojnë një urë midis rajoneve pjesëmarrëse në mënyrë që të adoptohen strategji të koordinuara



bashkërisht për ndërhyrje në raste zjarresh dhe përmbajtjes.

Përmirësimi i koordinimit dhe nivelit të përgatitjes së aktorëve kryesorë strategjikë të përfshirë në

fazën e parandalimit dhe menaxhimit të emergjencave në raste zjarri dhe përmbajtje. Promovimi i një modeli të përbashkët të parandalimit dhe ndërhyrjes që do të aktivizohet në vendet

partnere. Modeli do të zhvillohet përmes aktiviteteve të afta për të stimuluar shkëmbimin e përvojave dhe njohurive ndërmjet tre vendeve partnere, krijimi i modeleve të ndër-

rhyrjes dhe programeve trajnuese me sesione specifike mbi organizimin, protokollet dhe procedurat që aplikohen në vendet e pellgut të Adriatikut të Mesëm.

## KUVENDI I SHQIPËRISË RATIFIKOI MARRËVESHJEN USHTARAKE ME TURQINË

# 2,3 milionë dollarë do të përdoren nga Ministria e Mbrojtjes

Kuvendi i Shqipërisë ratifikoi të enjten e javës që kaloi, më 23 korrik 2020, marrëveshjen e bashkëpunimit financiar dhe ushtarak të nënshkruar me Turqinë, si dhe protokollin zbatues në lidhje me asistencën financiare mes dy vendeve. Drafti për ratifikimin e marrëveshjes u miratua me 105 vota pro, 4 kundër dhe 4 abstenime.

Gjatë fjalës së saj në seancë plenare, deputetja Elona Gjebrea tha se reforma e mbrojtjes dhe rristurimi i Forcave të Armatosura të Shqipërisë, integrimi në NATO dhe transformimi i mbrojtjes janë çështje të përbashkëta të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

"Që nga viti 1998, Kuvendi Shqipërisë ka ratifikuar 26 marrëveshje ushtarake, grante dhe protokolle me Qeverinë e Republikës së Turqisë. Turqia, ky partner strategjik i vendit tonë, e ka mbështetur në mënyrë të vazhdueshme Shqipërinë në fusha të ndryshme, përfshirë dhe logjistikën ushtarake në përputhje me programin për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare të vendit tonë", - deklaroi Gjebrea.



Sa i përket marrëveshjes së lartpërmendur, Gjebrea u shpreh me këto fjalë: "Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, 2,3 milionë dollarë ameri-

kanë do të përdoren për këto shërbime nga Ministria e Mbrojtjes. Është e domosdoshme që të merren të ardhura në të ardhmen që të thithen

të gjitha fondet në përputhje me marrëveshjet dhe protokollin ushtarak të miratuar në vendin tonë. Projektligji që do të miratohet sot, është në përputhje me politikën e Ministrisë së Mbrojtjes në kuadër të anëtarësimit të vendit tonë në NATO. Falënderojmë palën turke që na është gjendur në situatë të vështira, përfshirë dhe faktin që vendi ynë u godit nga tërmeti muajt e kaluar. Shpresoj që kjo mbështetje të vijë në ndihmë jo vetëm për modernizimin e Forcave të Armatosura, por dhe për emergjencat civile", - u shpreh deputetja përpara votimit për ratifikimin e marrëveshjes në fjalë. Sipas Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, marrëveshja e bashkëpunimit-nënshkruar mes palëve më 24.1.2020 dhe më 24.2.2020, ka për qëllim përcaktimin e parimeve në lidhje me dhënien e ndihmës financiare të alokuar, por të papërdorur, me qëllim që të blihen shërbime për qëllime ushtarake mundësisht nga firmat dhe shoqëritë që e kanë 100 për qind të prodhimit të brendshëm kryesisht në Turqi.

“MBYTET” NË DHËRMI ANIJA USHTARAKE “POLUMBARJA KINEZE”

# Një ish-anije ushtarake shndërrohet në një atraksion turistik

*Ajo do të shërbejë si një atraksion turistik në ujërat e Drimadhesit në Dhërmi për të apasionuarit pas zhytjes*

**N**jë ish-anije ushtarake është mbytur në Dhërmi më 28 korrik 2020, për t'u shndërruar në një atraksion turistik për të apasionuarit e botës nënujore. “Një destinacion i ri për zhytje.

Kjo ish anije ushtarake, tashmë do të shërbejë si një atraksion turistik nënujor”, - shkruan kryeministri Rama ne facebook. Në aktivitetin promovues të pranishëm ishin dhe ministri i Turizmit, Blendi Klosi, zëvendësministri i mbrojtjes Petro Koci, prefekti i Vlorës dhe përfaqësues të komandës ushtarake të Vlorës. Anija që u fundoset në Drimadhes ishte anije ushtarake e Marinës Shqiptare e vitit 1974. Kjo anije nuk përdorej prej 30 vitesh. Anija që u fundos në Drimadhes, në Dhërmi ka ardhur në Shqipëri nga Kina në vitin 1974 dhe ka qenë pjesë e marinës së Vlorës. Anija është zhytur rreth 200 m larg bregut në Drimadhes dhe do të mund të vizitohet nga të pasionuarit pas sportit të zhytjes. Në projekt janë parashikuar të zhyten edhe anije të tjera ushtarake, që kanë dalë jashtë funksionit. Emri i anijes që u mbyt është ‘Polumbarja Kineze’.

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, ka publikuar një video me pamje nga mbytja e ish-anijes ushtarake. “Në kushtet e reja, domosdoshmëria është që me hapjen e turizmit detar shqiptar, të zgjerojmë format dhe tematikat e ofertës turistike, me qëllimin e një turizmi dinamik dhe konkurrues në rajon. Vetëm pak ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit për aktivitetet detare, ligj i cili mundëson shfrytëzimin e hapësirës jo vetëm për peshkim, por edhe për turizëm elitare dhe aktivitete ujore, krijojmë sot një destinacion të ri për të gjithë turistët dhe të apasionuarit e detit që duan të eksplorojnë fundin e detit dhe atraksionet nënujore”, -theksoi Klosi.

Gjithashtu, shtoi Klosi: “ky destinacion nënujor do të jetë atraksion në zonën e Drimadhes dhe pjesë e hartës së aktiviteteve të turizmit detar, e cila miratohet në KKT”. “Këto harta parashohin vendet e lejuara dhe vendet e ndaluara të ushtrimit të aktivitetit detar. Përbëhet nga 60 zona, ku secila prej tyre do të ketë pasaportën e detajuar për Zonat e Lundrimit, zhytjes, peshkimit nënujor, destinacionet nënujore apo aktiviteteve të tjera ujore. Miratimi i këtyre hartave, “celebrohet” me ndërtimin e destinacioneve nënujore të mjeteve lundruese të përdorura nga forcat detare të Ministrisë së Mbrojtjes, që kanë dalë tashmë nga përdorimi dhe do të zhyten në ujë për të krijuar një atraksion turistik”, - shton Klosi.

Ai nënvizon se, “këto aktivitete do të jenë në përditësim të vijueshëm, duke patur pritshmërinë e një vlere të rritur ekonomike dhe ofertë e shtuar turistike për vendin. Në këto harta, planifikohen edhe zonat ku mund të



vendosen stacionet sezonale të ankorimit dhe pontilet lundruese”. “Miratimi i hartave të përgjithshme detare, i hap rrugë certifikimit të operatorëve të turizmit detar dhe prezantimit të ofertës turistike detare të vendit tonë. Për pothuaj 3 dekada, turizmi detar nuk ka patur asnjë lloj zhvillimi, duke e lënë bregdetin shqiptar një hallkë të munguar të zinxhirit të zonës së zhvilluar të Mesdheut”, - tha ai.

“Ligji i Turizmit Blu, synon nxitjen dhe ngritjen e porteve dhe marinave shqiptare. Ky ligj që ofron avantazhet më të larta në rajon, të regjistrimit të mjeteve të lundrimit për argëtim në vendin tonë. Përpos kësaj, mbajtja e flamurit shqiptar nga mjete detare që lundrojnë në të gjithë botën, ofron një marketim të Shqipërisë si destinacion turistik”, - shoti Klosi. “Shndërrimi i bregdetit shqiptar, në destinacionin më të njohur dhe të zhvilluar të jahteve në rajon, është synimi dhe pritshmëria e ligjit për veprimtaritë detare, një aktivitet që sjell të ardhura të larta në industrinë turistike”, - tha ai.

## QENDRA STERVITORE KUÇOVË

### Përfundon Kursi Bazë i Avancuar i Nënoficerit

**N**ë Qendrën Stërvitore të Kuçovës u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë dhe të Avancuar të Nënoficerit. Në këtë ceremoni mori pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Editson Zarka. Kolonel Zarka në fjalën tij përgëzoi drejtuesit e qendrës për përkushtimin dhe punën e bërë gjatë periudhës së COVID-19, për përgatitjen profesionale të kursantëve, ndërsa personelit të sapocertifikuar i uroi suksese dhe shtoi më tej se ky kurs do t’i shërbejë për marrjen e gradës së rradhës si tetar e rreshter dhe rritjen profesionale si teknikë të helikopterëve. Kjo ceremoni u mbyll me shpërndarjen e certifikatave për të gjithë kursantët dhe me një foto të përbashkët.



## Pas tërmetit 21 shtatorit 2019



### Fundjavën që kaloi mbaruan 37 shtëpi në Kavajë

“**N**ë më pak se një vit nga tërmeti i 21 shtatorit, 170 familje, banesat e të cilave u dëmtuan nga lëkundjet e tokës po hyjnë në shtëpitë e tyre të reja. Fundjavën që kaloi mbaruan 37 shtëpitë në Kavajë, ndërsa prej javësh kanë përfunduar edhe 100 banesa në Durrës, Kamëz e Krujë”, shkruan ministrja Xhaçka në facebook.

**Q**endra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2020 -2021, për 60 (gjashtëdhjetë) të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimiti universitar i përafrohet si vijon: Personel (Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Fakulteti Juridik), Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike), Logjistike (Fakulteti Ekonomik), Xhenio (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Pilot (Inxhinieri Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Sinoptikë (Inxhinieri Gjeoinformatik dhe Gjeografi), Këmbësori (Fakultetet e tjera) Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 17 korrik 2020. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është shtyer deri në 28 gusht 2020.

#### Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në ndjekje penale; të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata; të ketë figurë të pastër morale; të mos ketë probleme me deportimin; të mos ketë probleme me drogën dhe alkolin; të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale; në momentin e titullimit oficer aktiv, nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç (01 Gusht 2021). Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficer, të cilët do të jenë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç (01 Gusht 2021); të kenë gjatësinë trupore mbi 170 për meshkujt dhe mbi 165 cm për femrat; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit; të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMU-ja e FA-së; të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse, të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepaticke, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike; të jenë në zotërim të diplomës së arsimit të lartë, (minimumi beachelor) brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jomë pak se 6 (gjashtë); të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i



## Akademia e Forcave të Armatosura

# Viti akademik 2020-2021, aplikoni për 60 të drejta studimi

*Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit shtyhet deri më 28 gusht 2020*



punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislacionit në fuqi.

Kandidatët që rekrutohen nga rradhët e FA-së (nga rradhët e ushtarëve dhe nënoficerëve) përveç kriterëve të cituara më sipër duhet të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”; të mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara, skualifikohet.

#### Procedurat e aplikimit:

Kërkesën për të marrë pjesë në konkurrim, kandidatët ia adresojnë pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit. Kërkesa do të bëhet sipas modaliteteve të trajtuara në Aneksin A. Kandidatët që rekrutohen nga rradhët e ushtarëve/detarëve apo nënoficerëve aktivë, një kopje të kërkesës do t’ia drejtojnë komandës ku kryejnë shërbimin aktiv. Komandat brenda 5 ditësh nga marrja e kërkesës lëshojnë një rekomandimin për

pjesëmarrjen e kandidatit në konkurrim dhe cilësitë e tij.

#### Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e studimeve brenda vendit, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: a) Në fazën e regjistrimit kërkesë me shkrim; formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar në aneksi A; fotokopje e kartës së identitetit; fotokopje e noterizuar e

dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimimit të lartë së bashku me listën e notave të lëndëve; fotografi për dokument (4x6), 2 copë; formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë QPR-së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit; raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. analizat e gjakut për hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ose bangat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë. b) Në përfundim të testimit; Kandidatët që janë kualifikuar në testimet e zhvilluara, brenda 5 ditëve duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: dëshmi penaliteti; vërtetim nga gjykata; vërtetim nga prokuroria; vërtetim nga përbarimi; raporti mjekësor i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor i Njësisë Mjekësore Ushtrake. Qendra e Personel Rekrutimit të sigurojë dokumentacionin, i cili mund të shkarkohet online nëpërmjet portalit qeveritar “e-albania”, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kandidatët të sigurojnë vetë dokumentacionin e kërkuar në rastet kur për arsye teknike ai nuk mund të shkarkohet nëpërmjet portalit nga QPR-ja.

#### Datat e testimit:

Testi i Gjuhës së Huaj në gjuhën anglisht do zhvillohet 01.09.2020, Testi Fizik do të zhvillohet në datë 02.09.2020, Testi Intelektual zhvillohet në datë 03.09.2020 kurse Testi Psikologjik do të zhvillohet në datë 04.09.2020.

## FORCA E MBIKËQYRJES TOKËSORE TË ALEANCËS

# NATO dërgon në Sigonella-Itali, avionin e katërt të AGS

*Ky nga Kalifornia në Itali u kontrollua nga pilotët në Bazën Kryesore të Operacionit të Forcave të Mbikqyrjes së Tokës në Sigonella, në të njëjtën mënyrë si tre fluturimet e para*

Më 26 korrik 2020, avioni i katërt i pilotuar nga distanca i Forcës së Mbikqyrjes Tokësore të Aleancës së NATO (AGS) arriti në bazën e Forcave Ajrore Italiane në Sigonella, Itali. Avioni u ngrit nga Baza e Forcave Ajrore të Edvardit në Kaliforni, ShBA, në orën 18:33 me kohën lokale më 25 korrik dhe zbarkoi në Sigonella në 16:20 me kohën lokale të nesërmen, gati 22 orë më vonë.

Ardhja e avionit të katërt paraqet një tjetër hap të suksesshëm për Forcën e Mbikqyrjes Tokësore të Aleancës së NATO-s. Më pak se dy javë pas uljes së aeroplanit të tretë RQ-4D të pilotuar nga distanca, i quajtur gjithashtu "Phoenix", flota e pesë avionëve të përgjithshëm të NATO-s AGS Force është afër përfundimit.

"Ardhja e avionit të katërt rrit aftësitë tona me tepri dhe fleksibilitet më të madh. Forca AGS e NATO-s vazhdon përparimin tonë për t'u bërë siguruesi kryesor i informacionit rajonal 'indikacioneve dhe paralajmërimeve' për anëtarët e Aleancës së NATO-s", njoftoi komandanti i Forcave të AGS-së të NATO-s, gjeneralbrigade Houston Cantwell.

"Pasja e katër prej pesë avionëve të NATO-s AGS në Sigonella tregon përkushtimin dhe aftësinë e kombeve që blenë AGS dhe NAGSMA për të ofruar sistemin AGS të NATO-s ndërsa rritin fleksibilitetin tonë në testimin e sistemit. Ai siguron gjithashtu pajisje AGS Force të NATO-s shtesë



për njohje dhe trajnim", tha gjeneralbrigade Volker Samanns, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë. Ky kalim i fundit i Atlantikut nga Kalifornia në Itali u kontrollua plotësisht nga pilotët

e industrisë në Bazën Kryesore të Operacionit të Forcave të Mbikqyrjes së Tokës në Sigonella, në të njëjtën mënyrë si tre fluturimet e para. Pas mbërritjes, Agjencia e Menaxhimit

të Mbikqyrjes Tokësore të Aleancës së NATO-s dhe Autoritetet Italiane të Qarkullimit ajror do të përfundojnë dokumentacionin e kërkuar dhe dorëzimin e sistemit në Forcë sa

më shpejt të jetë e mundur. Blerja e Sistemit të Mbikqyrjes Tokësore të Aleancës është përgjegjësi e Agjencisë së NATO-s për Menaxhimin e Mbikqyrjes Tokësore (NAGSMA).



"Ardhja e avionit të katërt rrit aftësitë tona me tepri dhe fleksibilitet më të madh. Forca AGS e NATO-s vazhdon përparimin tonë për t'u bërë siguruesi kryesor i informacionit rajonal 'indikacioneve dhe paralajmërimeve' për anëtarët e Aleancës së NATO-s".

## PËRGJIGJA NDAJ KORONAVIRUSIT

## Spanja dorëzon furnizime mjekësore në Irak

Më 26 korrik 2020, si përgjigje ndaj një kërkesë për ndihmë ndaj COVID-19 nga Iraku, në Qendrën Euro-Atlantike të Koordinimit të Emergjencave ndaj Fatkeqësive të NATO-s (EADRCC), Spanja dorëzoi furnizime kritike mjekësore për autoritetet irakene. Dhurimi nga Ministria e Mbrojtjes Spanjolle iu dorëzua drejtorit të Qendrës Kombëtare të Operacioneve të kryeministrit, gjeneralmajor Mohamed Al Shimary, nga Zëvendës Shefi i Misionit të Ambasadës Spanjolle Mariana Figueroa Sánchez, gjatë një ceremonie të vogël në Bagdad International Airport.

Dërgesa e ndihmës përbëhej nga pajisje mjekësore thelbësore, përfshirë maska oksigjeni, doreza mbrojtëse personale, kostume mbrojtëse dhe maska për fytyrën N95, si dhe dezinfektues, pompa spërkatëse dhe ilaçe. Në bashkëpunim me Misionin e NATO-s Irak, Ambasada Spanjolle në Irak dhe Ministria Spanjolle e Mbrojtjes koordinuan dërgimin e sendeve në Irak duke përdorur një aeroplan komercial.

EADRCC është mekanizmi kryesor i NATO-s për reagimin



ndaj urgjencave civile. Qendra operon mbi bazën 24/7, duke koordinuar kërkesat dhe ofertat e ndihmës. Që nga fillimi i pandemisë COVID 19, EADRCC ka koordinuar kërkesa nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Koordinimin e Çështjeve Humanitare (OCHA) nga 16 vende të NATO-s dhe vendet partnere, duke rezultuar në dhjetëra oferta ndihme.

Misioni i NATO-s Irak është themeluar më 1 nëntor 2018 me

ftesë të Qeverisë së Republikës së Irakut dhe është e angazhuar për sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit. Është një mision këshillues, trainues dhe ndërtimi i kapaciteteve jo-luftarake dhe kontribuon në ndërtimin e sigurisë dhe stabilitetit duke ndihmuar Forcat e Armatosura të Irakut të bëhen të vetëqëndrueshme dhe gjithnjë e më efektive në mposhtjen e terrorizmit.

## Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Geoană

## Mjedisi kompleks i sigurisë e bën NATO-n më të rëndësishme

Duke folur në Simpoziumin Symi, në internet, në "The World post COVID-19" më 28 korrik 2020, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană theksoi rëndësinë e të qenit vigjilent, i përgatitur dhe i angazhuar përballë sfidave tradicionale dhe të reja të sigurisë. "Këto e kanë bërë mjedisin e sigurisë më komplekse dhe NATO-n më të rëndësishme", tha ai. "Ne nuk duhet ta lejojmë këtë krizë shëndetësore dhe rënie ekonomike të rezultojë në një krizë sigurie."

Si pjesë e procesit të reflektimit të NATO-s 2030, Z. Geoană theksoi vlerën e partneriteteve globale për mbrojtjen e vlerave të përbashkëta demokratike dhe nevojën për të identifikuar sinergjitë midis NATO-s dhe BE-së drejt rezistencës së zgjeruar. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s gjithashtu përshëndeti arritjen e Greqisë për qëllimin e shpenzimit të mbrojtjes së GDP për 2% të PBB-së.

Symi Simpozium është një takim vjetor i nivelit të lartë që mbledh së bashku liderë globalë, politikëbërës, intelektualë, ekspertë të çështjeve ndërkombëtare për të diskutuar çështje të aktualitetit dhe strategjisë. Këtë vit, aktiviteti u zhvillua nën kujdesin e Presidencës Greke të Këshillit të Evropës.





## QENDRA PËR STUDIME EURO-ATLANTIKE NË SERBI

## Java e NATO-s në Beograd

*Baiba Braze: “Serbia është një vend i rëndësishëm për NATO-n dhe ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë në mënyrën më të mirë të mundshme”*

Më 22 korrik 2020, Ndhmësja e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për Diplomacinë Publike, Baiba Braze, mori pjesë në Javën e NATO-s në Beograd, një ngjarje vjetore e organizuar nga Qendra për Studime Euro-Atlantike në Serbi dhe e mbështetur nga Divizioni i Diplomacisë Publike të NATO-s. Në një panel diskutimi në internet, Ndhmësja e Sekretarit të Përgjithshëm adresoi përgjigjen e NATO-s ndaj pandemisë dhe rolit të saj në forcimin e rezistencës ndaj dezinformatave.

Ajo foli për sfidën e dezinformimit në Ballkanin Perëndimor dhe rëndësinë e komunikimit të bazuar në fakte për të luftuar dezinformimin.

“Eshtë e rëndësishme që NATO të tregojë faktet-se solidariteti ekziston në partneritetin tonë. Serbia është një vend i rëndësishëm për NATO-n dhe ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë në mënyrën më të mirë të mundshme”, tha ajo.

Pjesëmarrës të tjerë në këtë aktivitet ishin ministri i Jashtëm serb Ivica Dačić, nënkryetari i Parlamentit Kombëtar të Serbisë Vladimir Marinković, shefi i Mbrojtjes serbe Milan Mojsilović, komandanti i KFOR gjeneralmajor Michele Risi dhe shefi i Zyrës Ndërlidhëse Ushtarake të NATO-s në Beograd, gjeneralbrigade Tommaso Vitale.



“Eshtë e rëndësishme që NATO të tregojë faktet-se solidariteti ekziston në partneritetin tonë. Serbia është një vend i rëndësishëm për NATO-n dhe ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë në mënyrën më të mirë të mundshme”.

Thirrje globale e KB për mbështetje ndaj pandemisë

## Mbretëria e Bashkuar dërgon spital fushor në Afrikën Perëndimore

Pas kërkesës globale të Kombeve të Bashkuara për ndihmë ajrore në përgjigje të pandemisë COVID 19, Forca Ajrore Mbretërore nga Mbretëria e Bashkuar transportoi një spital fushor nga Evropa në Akra, Ganë, në koordinim me Qendrën Koordinuese Euro-Atlantike të Reagimit të Fatkeqësive të NATO-s (EADRCC). Kombet e Bashkuara e përdorën këtë mekanizëm për t'i bërë thirrje për ndihmë aleatëve të NATO-s në transportimin e sendeve mjekësore të nevojshme urgjente. Me ndërprerjen e fluturimeve tregtare dhe kostoja e fluturimeve për ngarkesa u përshkallëzua, kjo mbështetje erdhi në një kohë të rëndësishme. Duke iu përgjigjur kërkesës së Kombeve të Bashkuara, një aeroplan ngarkesash i forcave ajrore Mbretërore në Mbretërinë e Bashkuar fluturoi me katër rotacione në Akra, Ganë më 27



qershor, 1 korrik, 2 korrik dhe 9 korrik 2020. Avioni transportonte furnizime për ndërtimin e një spitali fushor, nga ndihma e financuar prej Mbretërisë së Bashkuar që arrin në rreth 130 tonë material. Objekti do të përdoret për punonjësit e ndihmës së frontit në rajon për të ndihmuar në luftimin e pandemisë së koronavirusit dhe do të ketë kapacitetin për t'u kujdesur deri në 92 pacientë. Forca Ajrore Mbretërore në Mbretërinë e Bashkuar dorëzoi ngarkesat në emër të Programit Botëror të Ushqimit (WFP), i cili po merret me infrastrukturën dhe logjistikën për Kombet e Bashkuara.

“ZËRI I RESPEKTUAR I PËRGJEGJËSISË BRENDA NATO-S”

## Daniela Morgante Kryetarja e IBAN-it të NATO-s

Bordi Ndërkombëtar i Auditorëve për NATO-n (IBAN) është organi i pavarur, i auditimit të jashtëm të NATO-s. Mandati kryesor i tij është të sigurojë Këshillin e Atlantikut të Veriut dhe qeveritë e vendeve anëtare të NATO-s me siguri se fondet e përbashkëta janë përdorur siç duhet për shlyerjen e shpenzimeve të autorizuara.

Të udhëhequr nga tre vlera themelore - pavarësia, integriteti dhe profesionalizmi - IBAN përpiqet të jetë zëri i respektuar i përgjegjësive brenda NATO-s.

Daniela Morgante, e lindur në 1973 në Romë, Itali që nga 1 nëntori 2019, është Kryetare e Bordit Ndërkombëtar të Auditorëve për NATO-n (anëtare që nga 1 gusht 2019).

Ajo u diplomua në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Romës La Sapienza në 1996. Pas dy vjet praktikë në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm të Shtetit në Romë, në 1999 ajo u anëtarësua në CONSOB (autoriteti mbikëqyrës italian për letrat me vlerë dhe tregjet financiare), së pari si analist (Milano) dhe më pas si avokat (Romë). Në vitin 2001 ajo u rekrutua nga Banka e Italisë për Rregullimin e Mbikëqyrjen Bankare dhe Departamentin e Konkurrencës, në Romë.

Në vitin 2007 ajo kaloi procedurat e rekrutimit për gjyqtar të zakonshëm,



pastaj për gjyqtar administrativ dhe më pas për gjyqtar të kontabilitetit. Pasi u emërua gjyqtare e Gjykatës Rajonale Administrative për Piemonte, ajo mori detyrën si Gjykatëse e Gjykatës së Auditorëve, ku ajo ka shërbyer: Gjykata Rajonale e Auditimit për Veneto (2007-2010); Gjykata Ra-

jonale e Juridiksioneve për Puglia (2010-2013); si Zëvendës Prokuror i Përgjithshëm për Molise (2014-2016); si Kryeprokuror Rajonal për Alto-Adige / Sued Tyrol (2017-2019); si Gjyqtar Auditimi për Qendrën Italiane për Hulumtimin Hapësinor (2016-2019); si Gjyqtar Zëvendës Auditor për Qendrën


Enrico Fermi për Kërkime Shkencore (2011-2015); si Anëtar i Këshillit për Trajnimin e Auditimit (2012-2014).

Përvoja e saj në auditimin financiar, pajtueshmërinë dhe performancën plotësohet gjithashtu nga pozicione të auditimit shtesë, në Itali dhe jashtë saj, si: Anëtar i Kolegjit të Auditorëve të Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve të Gjykatës së Auditimit (2009-2012); Anëtar i Kolegjit të Auditorëve të Këshillit Drejtues të Gjykatave Tatiimore (2012-2013); Anëtar i Bordit të Auditorëve të Performancës për Menaxhimin e Spitalit Universitar Umberto I (2015-2017); Kryetar i Kolegjit të Auditorëve të Fondacionit FORMAP (Universitetet e Romës La Sapienza dhe të Napolit Federico II, 2016-2019); Anëtar (që nga 2015) dhe Kryetar (që nga 2017) i Kolegjit të Auditorëve të Institutit të Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë.

Ajo u emërua gjithashtu gjyqtare në

Gjykatën Kombëtare të Rregullave të Apelit në Gjykatën e Federatës Italiane të Futbollit në vitin 2016 dhe, në vitin 2017, Gjykatëse e Gjykatës së Taksave për Provincën e Firencës dhe Anëtare e Gjykatës së Arbitrazhit për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Alternative për Procedurat Financiare. Ajo ishte gjithashtu Këshilltare Ligjore e Ministrisë për Çështjeve Evropiane (2018-2019) dhe Zëvendës e Financave për Kryeqytetin e Romës (2013-2014).

Ajo dha mësim në kurse të nivelit Master dhe ligjëroi në seminare dhe konferenca (Universitetet e Romës La Sapienza, e Napolit Federico II, Pegaso, Shkolla Kombëtare e Administrimit, Institutit Rajonal i Studimeve Ligjore për Lazio ACJemolo, ITA, CEIDA dhe të tjerë) në fushat e auditimit dhe kontabilitetit në sektorin publik dhe të ligjit administrativ dhe financiar. Ajo është autore e mbi 80 artikujve dhe komenteve të botuara në revista, traktate dhe komente. Në vitin 2018, ajo u emërua Zëvendës Drejtore e Gazetës së Gjykatës Italiane të Auditimit. Ajo gjithashtu iu bashkua komiteteve shkencore, si për Gazetën e Drejtësisë Publike Italiane, Evropiane dhe Krahasuese të Federalizmit (2012) dhe për Masterin në Federalizëm Fiskal në Universitetin e Romës La Sapienza (2011).



Për angazhimin e FSK-së, në kuadër të gjendjes së pandemisë COVID-19, ku FSK-ja ka dhënë kontributin në mbështetje të autoriteteve civile, në logjistikë, transport dhe gatishmërinë që ka për të dhënë mbështetje me kapacitete shtesë, në raste të përkeqësimit të gjendjes, duke vënë në dispozicion edhe kapacitetet për akomodim dhe për trajtim.



KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI VIZITË NË MINISTRINË E MBROJTJES

# Me rëndësi bashkëpunimi me partnerin strategjik, SHBA-të

*Ngritja e FSK-së është në koordinim me partnerin strategjik SHBA, në transparencë me NATO-n*

**K**ryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, së bashku me ministrin e Shëndetësisë Armend Zemaj, kanë vizituar më 28 korrik, Qendrën Mjekësore të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë. Kryeministri Hoti, fillimisht u prit në ambientet e ministrit, nga ministri Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm i MM-së, Faruk Geci, shefi i Kabinetit të Ministrisë, Jashar Ramadani, si dhe stafi i lartë i ministrit dhe FSK-së.

Ministri Anton Quni pas urimit të mirëseardhjes e njoftoi kryeministrin Hoti, me gjendjen si e ka gjetur ministrinë dhe FSK-në, me punën e mirë që është bërë edhe nga ministrat paraprak dhe me angazhimet aktuale për tranzicionin e FSK-së, bazuar në ligjet e reja dhe në misionin e ri, që ka si ministria e Mbrojtjes ashtu dhe FSK-ja, duke i kushtuar vazhdimisht rëndësi bashkëpunimit me partnerin strategjik SHBA-të, bashkëpunimet bilaterale, për prezencën dhe bashkëpunimin e mirë me ekipin e NALT-it, që është prezentë, si në ministri ashtu edhe në Forcë.

Për angazhimin e FSK-së, në kuadër të gjendjes së pandemisë COVID-19, ku FSK-ja ka dhënë kontributin në mbështetje të autoriteteve civile, në logjistikë, transport dhe gatishmërinë që ka për të dhënë mbështetje me kapacitete shtesë, në raste të përkeqësimit të gjendjes, duke vënë në dispozicion edhe kapacitetet për akomodim dhe për trajtim.

Ndër të tjera, ministri Quni e njoftoi kryeministrin Hoti edhe me luftën speciale që po bëhet në mediat ruse, se gjoja FSK-ja, ka blerë armatim fshehurazi nga Gjermania, me vlerë deri në 170 milion euro, të gjitha këto sipas ministrit Quni bëhen për të destabilizuar paqen në Ballkan, dhe për të krijuar pretekst për armatosjen e mëtejshme të Serbisë, si dhe duke tentuar të komprometojë bashkëpunimin tonë të mirë dhe transparent me shtetin e Gjermanisë.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me këtë rast, e njoftoi kryeministrin Hoti me angazhimet konkrete të FSK-së, me planin e zhvillimit dhe transformimit, me trajnimet dhe shkollimet që po bëjnë ushtarët dhe oficerët e FSK-së, në akademitë ushtarake të vendeve mike dhe partnere. Për menaxhimin e financave të FSK-së, buxhetin aktual dhe pajisjen me teknikë të nevojshme për të rritë operacionalitetin e FSK-së, sipas planit të zhvillimit dhe ngritjes së FSK-së. Ai foli për takimin që ka pasur me ministrin e shëndetësisë Armend Zemaj, për bashkëpunimin e mirë që ka Qendra Mjekësore e FSK-së me ministrinë e Shëndetësisë dhe me QSUK-në.

Në fjalën e tij, kryeministri Hoti, falenderoi për pritjen duke i shprehur

përgëzimet ministrit Quni dhe komandantë Ramës, për punën e bërë deri më tani, duke theksuar se FSK-ja është me besueshmëri më të lartë në vend, që na bënë të ndihemi krenarë të gjithëve, dhe është një histori suksesi, vlerësim që e ka dëgjuar edhe nga partnerët ndërkombëtarë.

Ai me këtë rast, shprehu gatishmërinë në emër të qeverisë së tij, për të dhënë mbështetjen e duhur pavarësisht rrethanave aktuale, për të punuar në zbatimin dhe realizimin e planit të transformimit dhe ngritjeve të kapaciteteve të FSK-së.

Gjatë vizitës në Qendrën Mjekësore të FSK-së, kryeministri Hoti u shoqërua nga ministri Zemaj, ministri Quni, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, sekretari i përgjithshëm i MM, Faruk Geci dhe zyrtarë të tjerë të lartë. Ai u prit nga përgjegjësi major Adem Preteni, i cili prezantoi kapacitetet e kësaj qendre, mjetet që posedojnë, dhomat e akomodimit në rast nevojë për të shtruar të sëmurët dhe kapacitetet e tjera që ka kjo qendër.

Duke vlerësuar lartë punën e FSK-së, në deklarinim para mediave,

kryeministri Hoti, tha: "Inspektuam spitalin ushtarak për të parë kapacitetet që ka FSK-ja, do t'i vëmë në dispozicion në rast se do të kemi nevojë t'i përdorim. Unë nuk jam njeri ushtarak, por jam i impresionuar dh i emocionuar me disiplinën ushtarake. Do të punojmë së bashku me stafin për të përballuar situatën nëpër të cilën po kalojmë. I falenderova për mbështetjen që ka dhënë FSK-ja për institucionet e tjera që tash po duket se po përkeqësohen dhe ne duhet të përgatitemi për të gjitha variantet që

i kemi përpara".

Më pas, kryeministri Hoti me gjithë delegacionin, vizituan automjetet e blera HMMWV që ishin të rreshtuara në pistën e FSK-së. Në fund të këtij aktiviteti, ministri Quni, duke ju përgjigjur interesimit dhe pyetjeve të gazetarëve, dha një prononcim për deklaratat e fundit që vijnë nga Rusia dhe Serbia, dhe tendencën e kësaj të fundit për armatosje shtesë. Ministri Quni deklaroi se kapacitete kërcënuese posedon Serbia, si me armatimin që ka, me teknologjinë prodhuese dhe buxhetin e lartë që posedon, kurse Kosova është e orientuar në kapacitete mbrojtëse, e ka buxhetin transparent, dhe ngritja e FSK-së, është duke u bërë në koordinim me partnerin strategjik SHBA, dhe në transparencë me NATO-n, duke shprehur gatishmërinë e FSK-së, për tu angazhuar në misione paqësore, se FSK-ja është forcë që rritë stabilitetin në rajon dhe me gjerë. Kosova nuk ka shprehur asnjëherë ambicie territoriale ndaj fqinjëve, ashtu si Serbia që e ka Kosovën ende në preambulën e kushtetutës së saj.

PLANI GJITHËPËRFSHIRËS:

## Arritja e kapaciteteve operacionale deri në vitin 2027

**N**ë ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ministri i Mbrojtjes Anton Quni ka raportuar para Komisionit Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, lidhur me zhvillimet e përgjithshme aktuale të FSK-së, sfidat aktuale, si dhe objektivat zhvillimore për të ardhmen. Ndër të tjera, Ministri Quni njoftoi të pranishmit se përkundër krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19 dhe fokusit për luftimin e saj, ministria e Mbrojtjes dhe FSK ka arritur me sukses të realizojë pjesën më të madhe të aktiviteve të planifikuara, në funksion të përbushjes së objektivave të ministrit të Mbrojtjes dhe qeverisë në përgjithësi. Ai gjithashtu theksoi se, meqë jemi në vitin e dytë të procesit të tranzicionit të FSK-së, në misionin e forcës ushtarake, edhe objektivat tona janë me fokus në


përbushjen e aktiviteve në përputhje me Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, gjithnjë në drejtim të arritjes së aftësive dhe kapaciteteve të plota operacionale deri në vitin 2027, kapacitete këto të nevojshme për përbushjen e misionit kushtetues dhe ligjor. Pas ekspozesë së ministrit Quni, anëtarët e komisionit përkatës të kryesuar nga Znj. Fatmirë Kollçaku-Mulhaxha, parashtruan pyetje me interes, lidhur me statusin e projekteve kapitale të FSK-së në rishikimin buxhetor, gjendjen e pjesëtarëve në rrethanat e pandemisë COVID-19, për idenë e shërbimit të obligueshëm ushtarak, rregulloren e pagave për pjesëtarët e FSK-së, procesin e integritetit të pjesëtarëve nga radhët e komuniteteve jo-shumicë dhe sfidat në këtë proces, politikat konkrete në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare,

kapacitetet e diplomacisë ushtarake si dhe memorandumet e bashkëpunimit bilateral dhe multilateral. Për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e komisionit, si dhe për çështje specifike, ministri Quni dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama e u.d. sekretari i përgjithshëm Faruk Geci, ofruan përgjigjet me informacione të plota dhe të qarta duke përbushur në mënyrë të plotë obligimin ligjor në funksion të transparencës dhe llogaridhënies së plotë para përfaqësuesve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si organi kushtetues i ushtrimit të kontrollit demokratik parlamentar, mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ministri Quni gjithë takimit shoqërohej edhe nga këshilltari i tij ushtarak, kolonel Hamdi Pollomi dhe zyrtarja e lartë e kabinetit të tij, Martina Dedaj-Kçira.



### Marrëveshje bashkëpunimi midis FSK-së dhe Humanity First

**M**ë 28 korrik, ditën e martë, në ambientet e Qendrës Mjekësore të FSK-së, u nënshkrua një Marrëveshje bashkëpunimi në mes FSK-së dhe të KK të Prishtinës, Humanity First. Në emër të FSK-së, marrëveshjen e nënshkroi drejtori i përgjithshëm i QMFSK-së, Dr. Shkëlzen Sylaj. Kjo marrëveshje ka për qëllim pajisjen me tunel dezinfektues për nevojat e FSK-së, dhe do të bëhet e mundur dezinfektimi i gjithë personelit ushtarak, si dhe vizitorët eventual, të cilët frekuentojnë këtë kazermë. Sipas marrëveshjes pritet që brenda kësaj jave të vendoset tuneli në hapësirat që do t'i përcakton Shtabi i Përgjithshëm i FSK-së.



Presidenti Pendarovski pati një bisedë-video, me një rreshter të lartë të klasit të parë Fatime Mustafovska, i cili është pjesë e ekipit të angazhuar në CGH “8 Shtator” dhe i cili deri në transformimin e Spitalit Ushtarak, ka punuar në departamentet kirurgjikale.



Presidenti Pendarovski në Batalionin e Ndhmës Mjekësore Ushtarake

# Stafi mjekësor ushtarak-në disa operacione paqëruajtje

*Stafi i qendrës mjekësore ushtarake ka marrë pjesë në operacionet paqëruajtjeje në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, misionet “ISAF” në Kabul dhe në Maimana*

Presidenti i Republikës së Maqedonisë veriore dhe komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Stevo Pendarovski, i shoqëruar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Vasko Gjurginovski, vizituan më 28 korrik, anëtarët e Batalionit të Ndhmës Mjekësore Ushtarake.

Pas shpalljes së pandemisë së virusit COVID-19, stafi i qendrës u përfshi aktivisht në mbështetjen e stafit të institucioneve shëndetësore publike. Me kërkesë të ministrisë së Shëndetësisë në Mars, një ekip nga Qendra Mjekësore Ushtarake ngriti një spital manovrimi përpara Klinikës së Sëmundjeve Infektive në Qendrën Klinikë Nënë Tereza, për të rritur kapacitetin në rast të një fluksi të pacientëve COVID-19.

Stafi mjekësor ushtarak nga kjo njësi është angazhuar në Qendrën për Shëndet Publik dhe në CGH “8 Shtatori”. Komandanti i kësaj njësie, koloneli Irena Mineva informoi presidentin Pendarovski se ekipi që është i angazhuar për nevoja të CGH “8 Shtatori”, është i përbërë nga teknikë me përvojë mjekësore që kanë punuar në ish Spitalin Ushtarak. Ata menjëherë u vendosën në njësinë e kujdesit intensiv dhe në një dhomë shoku, ku janë vendosur pacientët me sëmundje më të rënda, me COVID-19.

Gjatë vizitës, Presidenti Pendarovski pati një bisedë-video, me një rreshter të lartë të klasit të parë Fatime Mustafovska, i cili është pjesë e ekipit të angazhuar në CGH “8 Shtator” dhe i cili deri në transformimin e Spitalit Ushtarak, ka punuar në departamentet kirurgjikale. Duke theksuar se puna me pacientë të sëmurë rëndë është shumë specifike, Presidenti Pendarovski tha: “Mbetet të shihet nëse kriza pandemike COVID-19, së shpejti do të përfundojë dhe nëse profesionistët e shëndetit dhe të gjithë ata që janë të përfshirë në trajtimin e efekteve të pandemisë do të jenë në gjendje të marrin frymë dhe të çlirohen nga stresi dhe rreziku i përditshëm”.

Presidentin Pendarovski e informoi Kolonel Mineva për punën e njësisë, misionin e saj dhe planet e ardhshme. Si një anëtar i NATO-s, siç tha Presidenti Pendarovski, është e nevojshme që qendra mjekësore ushtarake, të pajiset siç duhet dhe të funksionojë në mënyrë të përsosur si më parë. Misioni kryesor i qendrës është ruajtja dhe përmirësimi



i shëndetit dhe ruajtja e gatishmërisë luftarake të pjesëtarëve të ushtrisë, në nivelin e kërkuar. Përveç misionit bazë, njësi është përgjegjëse për Spitalin Manovrim Tokësor me Rolin 2. Në vitin 2014, KMB me Rolin 2 u vlerësua sipas konceptit të NATO-s për vlerësimin e aftësive operacionale dhe

mori notat më të larta sipas të gjitha kriterëve. Gjithashtu, stafi i qendrës mjekësore ushtarake ka marrë pjesë në disa operacione paqëruajtjeje, dmth “ALTHEA” në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, në misionet “ISAF” në Kabul dhe në Maimana, Republika Islamike e Afganistanit.




## Trajnim zjarri me anëtarët e Batalionit të 4-të të Këmbëorisë

Anëtarët e Batalionit të 4-të të Këmbëorisë (Divizioni i 4 i Këmbëorisë) nga Brigada e 1 e Këmbëorisë (Divizioni i 1 i Këmbëorisë), duke i'u përmbajtur të gjitha masave dhe rekomandimeve të përdorura në trajtimin e pandemisë, kryejnë detyrat e tyre të rregullta me intensitet të pakënaqur.

Duke marrë parasysh periudhën e verës, temperaturat e larta dhe mundësinë e zjarreve të shpeshta, anëtarët e 4.pb, në bashkëpunim me Brigadën e Zjarrfikësve nga qyteti i Kërçovës, patën mundësinë të njihen me mënyrën dhe aplikimin e pajisjeve të zjarrit (PP) dhe gjithashtu zhvilluan trajnime për PP në tema “Llojet e zjarreve, pajisjet e zjarrfikësve dhe ndihma e parë në rast të dëmtimeve nga zjarri”.

Kryerja e trajnimeve për zjarrfikës, është një aktivitet i rregullt për anëtarët e ushtrisë, në këtë kohë të vitit.



Ministrja Shekerinska takon gjeneralin Erik Vent

## Maqedonia e Veriut intensifikon bashkëpunimin me Aleancën

Më 22 korrik 2020, Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska pati një takim me gjeneralin Erik Vent, komandantin e Komandës së Forcave Speciale të NATO-s. Maqedonia e Veriut, si anëtare e re e 30-të, intensifikon bashkëpunimin me Aleancën në të gjitha fushat. Ministrja falenderoi për mbështetjen që vendi ynë pati në rrugën drejt anëtarësimit në NATO dhe shprehu gatishmërinë për të thelluar më tej partneritetin drejt arritjes së qëllimeve të përbashkëta të paqes dhe stabilitetit në rajon dhe në botë. Njëkohësisht komandanti i Forcave Speciale të NATO-s, gjenerallejtënant Eric Vent, zhvilloi vizitë të planifikuara në ushtrinë e Republikës së Maqedonisë Veriore. Në takimin midis shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, gjenerallejtënant Vasko Gjurginovski dhe Gjeneral Ventit diskutuan për misionin dhe detyrat e Forcave Speciale në ushtri, forcimin dhe zgjerimin e aftësive brenda NATO-s, mbrojtjen gjithëpërfshirëse dhe forcimin e bashkëpunimit. Gjatë kësaj vizite, gjeneral Vent vizitoi edhe Batalionin e Qëllimeve Speciale, ku u prezantuan edhe aftësitë e njësisë.

Vizita në Maqedoninë e Veriut, ishte një ditë më pas nga vizita që zyrtari i lartë i NATO-s, gjenerali Erik Vent, komandant i Komandës së Forcave Speciale të NATO-s, zhvilloi në Tiranë, ku u takua me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH.

Gjenerallejtënant Eric P.Wendt është një ushtarak amerikan karriere. Ai ka një diplomë “Bachelor” nga Universiteti i Kalifornisë, në Santa Barbara për “Drejtsi dhe Shoqëri” dhe një master për “Çëshjtje të Sigurisë Kombëtare” nga shkolla Pasuniversitare Detare në Monterey, California. Eric P.Wendt ka një karrierë të gjatë ushtarake. Ai ka shërbyer si një oficer aktiv i ushtrisë amerikane që nga viti 1986. Ai shërbeu gati pesë vjet në këmbësori, dhe më pas ka shërbyer si një Green Beret, oficer i forcave speciale. Wendt ka shërbyer në disa vende të botës, si në: Indonezi si shef Ekipi për komandantin e Komandës së SHBA-ve në Paqësor, në Ekipin e Vlerësimit të Situatës së Paqësorit (PSAT), në operacionin Liria e Qëndrueshme-Filipine (OEF-P) në Mindanao në jug të Filipineve, në operacionin Liria e Irakut (OIF) dhe në operacionin Liria e Përhershme-Afganistan (OEF-A). Përveç pozicioneve të shumta, duke përfshirë shërbimin si Ndhmësi Kryesor Ushtarak i sekretarit të Mbrojtjes, ai ka komanduar në çdo nivel të Forcave Speciale nga A-Team (ODA) deri në Komandën e Operacioneve Speciale të Teatrit Nën-Unifikuar (TSOC).

Gjenerallejtënant Eric P.Wendt flet anglisht, arabisht dhe gjuhën koreane. Atij i është akorduar “Kryqi i Artë Gjerman i Nderit” për shërbimin luftarak në Afganistan, medalja “Cheon Su” nga Presidenti i Republikës së Koresë, etj. Gjenerallejtënant Eric P.Wendt ka qenë edhe Koordinator i Sigurisë së Shteteve të Bashkuara, Izraelit dhe Autoritetit Palestinez. Gjenerallejtënant Eric P.Wendt mori komandën e Forcave Speciale të NATO-s, në 7 Nëntor 2019.



Ministri Karakachanov duke ju drejtuar ushtarakëve të rinj, tha se “ju bëheni komandantë në një ushtri, e cila në historinë e saj gati 1.400-vjeçare ka meritën kryesore për mbijetesën dhe ekzistencën e shtetit, shtetësisë dhe kombit bullgar. Mos harroni një gjë, në historinë e saj të gjatë Bullgaria ka si burra të fortë shteti edhe shtetarë të turpshëm, ka pasur parti që kanë qeverisur mirë dhe ato për të cilat kemi turp dhe historia i ka harruar.



MINISTRI KARAKACHANOV NË SHKOLLËN USHTARAKE “VASIL LEVSKI”

# Ndiqni traditat e lavdishme të Ushtrisë Bullgare

**M**inistri i Mbrojtjes i Bullgarisë, z.Krassimir Karakachanov mori pjesë më 24 korrik 2020, në ceremoninë zyrtare të maturantëve, në dhënien e gradës së parë të oficerëve, në shkollën e mesme Kombëtare Ushtarake (NMU) “Vasil Levski” në Veliko Tarnovo.

Në ceremoni, mori pjesë Presidenti i Bullgarisë dhe komandanti i Përgjithshëm Rumen Radev, zëvendës shefi i Mbrojtjes gjenerallejtënant Dimitar Iliev, komandanti i Forcave Ajrore gjeneralmajor Tsanko Stoykov, komandanti i Komandës së Forcave të Përbashkëta, gjenerallejtënant Lyubsho Todorov atashë, përfaqësues të autoriteteve lokale dhe shtetërore.

Në fjalën e tij, ministri Karakachanov duke ju drejtuar ushtarakëve të rinj, tha se “ju bëheni komandantë në një ushtri, e cila në historinë e saj gati 1.400-vjeçare ka meritën kryesore për mbijetesën dhe ekzistencën e shtetit, shtetësisë dhe kombit bullgar. Mos harroni një gjë, në historinë e saj të gjatë Bullgaria ka si burra të fortë shteti edhe shtetarë të turpshëm, ka pasur parti që kanë qeverisur mirë dhe ato për të cilat kemi turp dhe historia i ka harruar. Por një gjë duhet të mbajmë mend - populli bullgar kurrë nuk është turpëruar për ushtrinë e tij. Ajo ka për detyrë - të mbrojë integritetin territorial, sovranitetin e shtetit bullgar, jetën dhe prosperitetin e kombit bullgar”.

“Bashkohuni në radhët e Ushtrisë Bullgare si oficerë krenarë, sepse ju jeni udhëheqës jo vetëm të njerëzve që do të jenë vartësit tuaj nesër, por edhe në shoqërinë bullgare. Keni atë besim, ju e meritoni atë. Shumë vështirësi dhe sprova ju presin. Ushtria bullgare është ende në proces të riorganizimit dhe modernizimit. Do të ketë shumë probleme që do të keni për të zgjidhur. Mos harroni vartësit tuaj që do t’ju shikojnë dhe do të presin shembullin tuaj. Ndiqni traditat e lavdishme të ushtrisë bullgare dhe komandantëve bullgarë. Jam i bindur që shërbimi juaj nuk do të jetë i lehtë, por do të jetë i denjë dhe do të fitojë respektin për gjithë shoqërinë bullgare dhe krenarinë e prindërve tuaj”, -tha ministri Karakachanov.

“Jam i ngazëllyer sepse 142 vetë diplomuar ushtarakë, po i bashkohen Ushtrisë Bullgare. Ata duhet të kenë besimin se janë të diplomuar në një institucion me histori dhe sukses të dëshmuar në trajnimin e komandantëve të gatshëm për t’i shërbyer atdheut me njohuri, guxim dhe moral”, -theksoi zëvendës shefi i Mbrojtjes, gjenerallejtënant Dimitar Iliev.



jetënant Dimitar Iliev.

“Ne sot i tregojmë me krenari gjithë kombit se ushtria bullgare ka një gjeneratë të re të rinjsh të ditur, të aftë dhe shumë të motivuar. Këta janë maturantët e Shkollës së Mesme Kombëtare të “Vasil Levskit”. Ata e duan

Bullgarinë dhe janë rritur në frymën e traditave të shëndetshme patriotike. Ata janë krenaria jonë. Ata duhet të jenë krenaria e shoqërisë”, -theksoi kreu i shkollës Ushtarake Kombëtare “Vasil Levski”, kolonel Ivan Malamov në fjalimin e tij zyrtar.



## Anija “Bodri” kthehet nga stërvitja “Breeze 2020”

Anija “Bodri” nga Divizioni i Parë i anijeve patrulluese nga Flotilla e Anijeve luftarake dhe anijet ndihmëse të Marinës, u kthye në bazën në Varna, më 27 korrik, pas një udhëtimi nëntëditor. Anija luftarake mori pjesë në stërvitjen pesë-ditore SHBA-Ukrainë “Deti i Flladës 2020” në Detin e Zi. Gjatë tij, u kryen veprime mbi mbrojtjen e anijeve, anti-aeroplanët dhe mbrojtjet anti-nëndetëse, sinjalizimin dhe komunikimin. Në to morën pjesë edhe Grupi i Dytë i Përhershëm i anijeve të NATO-s.



## 20 të rinj do të specializohen si mjek ushtarak

20 të rinj (8 djem dhe 12 vajza) u pranuan të studionin në specialitetin “mjek ushtarak”. Kjo është klasa e katërt e formuar si rezultat i bashkëpunimit trepalësh midis Akademisë Mjekësore Ushtarake (MMA), Shkollës së Lartë Detare “N. J. Vaptsarov” dhe Universitetit Mjekësor “Prof. Dr. Paraskev Stoyanov” - Varna. Trajnimi gjashtë vjeçar për kadetët në të dy universitetet është falas, dhe pas diplomimit ata marrin dy diploma: një diplomë master në mjekësi dhe një diplomë bachelor në “Organizimin dhe menaxhimin e formacioneve ushtarake në nivelin taktik”, si dhe një kontratë pune 10-vjeçare si mjek ushtarak. Gjatë studimeve të tyre, akomodimi, ushqimi, veshmbathja ushtarake dhe mjekësore, tekstet shkollore dhe mjetet mësimore, bursa, pjesëmarrje në forume shkencore, tarifa, të cilat përballohen tërësisht nga Akademia Mjekësore Ushtarake. Pas përfundimit të trajnimit ata marrin mundësinë e specializimit në Akademinë Mjekësore Ushtarake dhe trajnim të përparuar jo vetëm në Bullgari, por edhe në të gjitha vendet anëtare të NATO-s.

## Forca Tokësore shuan zjarrin në Stara Zagora

Ushtarët nga Batalioni i 38-të i Brigadës së Dytë të Mekanizuar, ndihmuan për të shuar një zjarr pyjor mbi fshatin Dalboki, rajoni i Stara Zagora. Në 26 korrik, 24 persona u angazhuan në shuajrjen e zjarrit nën drejtimin e kapitenit Gerasim Zlatinov. Zjarri shpërtheu në një zonë të pyllëzuar dhe të paarrtshme sipër fshatit Dalboki. Ekipi i specializuar arriti të parandalojë pasojat katastrofike. Kërkesa u bë nga Drejtoria e Përgjithshme “Siguria nga zjarri dhe mbrojtja e popullatës” dhe me urdhër të komandantit të Forcave Tokësore, gjeneralmajor Mikhail Popov.



## Koreja e Jugut

## Do ndërtohet raketa hapësinore me karburant të ngurtë

*“Kjo do të ndihmojë në avancimin e aftësive të inteligjencës, mbikëqyrjes dhe zbulimit të ushtrisë së Koresë së Jugut”*

**K**oreja e Jugut ka njoftuar se tani do të jetë në gjendje të zhvillojë raketa hapësinore me lëndë djegëse të ngurtë nën udhëzimet e raketave të korigjuara, duke krijuar mundësi për zgjerimin e aftësive të mbikëqyrjes, mbi Gadishullin Korean.

Agjencia e lajmeve Yonhap raportoi se zhvillimi vijon pas heqjes së kufizimeve amerikane disa dekadash ndaj Seulit, mbi përdorimin e raketave të mbushura, me të ashtuquajturën karburant të ngurtë. Kjo do t'i mundësojë vendit të fluturojë satelitët spiunë ushtarak në orbitë të ulët, në lartësi mbidetare prej 500-2.000 kilometra.

Nënkryetari i Këshillit të Sigurisë Kombëtare të Koresë së Jugut, Kim Hyun-chong, u tha gazetarëve se kompanitë e Koresë së Jugut, institutet dhe individët hulumtues do të jenë teknikisht të aftë të zhvillojnë, prodhojnë dhe posedojnë raketa hapësinore duke përdorur lëndë djegëse të lëngshme, por edhe të ngurtë hibride “pa asnjë kufizim”.

Të dyja palët rishqyrtuan udhëzimet e raketave të nënshkruara për herë të parë në vitin 1979, më vonë në vitin 2017 e ndryshuar dhe plotësuar, për të hequr një kapak ngarkese prej 500 kilogramësh, për raketat balistike të Koresë së Jugut me rreze prej 800 kilometrash.

“Kjo do të ndihmojë në avancimin e aftësive të inteligjencës, mbikëqyrjes dhe zbulimit të ushtrisë së Koresë së Jugut”, tha Hyun-chong. Në mënyrë efektive, tha Hyun-chong, mar-



rëveshja e re midis Washingtonit dhe Seulit do të ndihmojë të dy aleatët të vëzhgojnë “gjithë Gadishullin Korean gjatë ditës dhe natës”. Nëse zhvillimi do të shkaktojë një reagim

nga Koreja e Veriut, ende pritet për t'u kuptuar pasi Pheniani për dekada të tëra ka qenë i matur në lidhjet ushtarake midis SHBA-ve dhe Koresë së Jugut.



## Google zgjat punën online deri në korrik 2021

Google njoftoi se për shkak të pandemisë, ajo ka zgjatur deri në korrik të vitit 2021 politikën që mundëson për punonjësit e saj të punojnë nga shtëpia. Afati i mëparshëm për punë online nga shtëpia ishte caktuar për në fund të vitit 2020, me leje për t'u rikthyer në zyrë vetëm në disa raste. Në fund të muajit maj, kompania “Mountain View” njoftoi se punonjësit e parë do të ishin në gjendje të ktheheshin në tavolinat e tyre duke filluar nga 6 korriku, por fillimisht duke përdorur vetëm 10% të kapacitetit të zyrës. “Meqenëse ne parashikojmë që shumica e të punësuarve do të punojnë kryesisht nga shtëpia për pjesën tjetër të këtij viti, ne do t'i japim secilit një ndihmë prej një mijë dollarë ose vlerën ekuivalente në vendin e tyre, për pajisjet e nevojshme dhe shpenzimet e mobiljeve për zyrë”, theksoi drejtuesi i Google, Sundar Pichai.



## Lëshohet sonda e parë arabe drejt Marsit

Emiratet e Bashkuara Arabe festuan lëshimin e anijes së tyre “Al-Amal” (“Shpresa”) në planetin Mars, misioni i parë ndërplanetar i ndërmarrë nga një vend arab. Pas dy shtyrjeve për shkak të motit të keq, ngritja e sondës e kryer nga një hedhës japonez nga qendra hapësinore “Tanegashima” në Japoninë Jugperëndimore, u përshëndet nga EBA. Entuziazmi mbretëroronte në Qendrën Hapësinore “Mohammed bin Rashid”, që drejtoi projektin mbi të cilin punuan rreth 450 persona, më shumë se gjysma e të cilëve ishin nga EBA. “Al-Amal” pritet të arrijë në orbitën e Marsit në shkurt 2021, me rastin e 50-vjetorit të bashkimit të EBA-s.

## KE: 5G mund të jetë europiane në BE

Grupet europiane Nokia dhe Ericsson mund t'i ofrojnë Bashkimit European gjithçka që duhet për të zhvilluar infrastrukturën 5G nëse grupi kinez Huawei do të mënjanohej për arsye sigurie, theksoi sot Komisioni European. “Grupet europiane janë në gjendje të sigurojnë atë që i duhet Evropës”, siguroi një zyrtar european. “Tre grupet ofrojnë zgjidhje të plota për 5G, finlandezi “Nokia”, suedezi “Ericsson” dhe kinezi “Huawei”, theksoi një funksionar european. “Të tjerë, si korani “Samsung” dhe kinezi “ZTE” ofrojnë zgjidhje për një pjesë të rrjetit”, shtoi ai. “Por siguria duhet të vijë e para në zgjedhjet europiane”, nënvizoi Komisioni në një raport të publikuar sot. “Është më e rëndësishme se kurrë të sigurohet një nivel i lartë sigurie gjatë vendosjes së rrjeteve 5G në BE me qëllim të rritjes së nevojave për infrastrukturë digjitale në ekonominë tonë”, shpjegoi komisioneri i Tregut të



Brendshëm, Thierry Breton. “Në bashkëpunim me shtetet anëtare, ne jemi të përkushtuar të vendosim masa të besueshme, të koordinuara, jo vetëm për të garantuar sigurinë kibernetike të 5G, por edhe për të forcuar autonominë tonë teknologjike”, shtoi ai në një deklaratë. “Integriteti i rrjeteve telekomunikuese

është gur themeli i një arkitekture të sigurt në të gjitha shtetet anëtare”, theksoi Ministri gjerman i Brendshëm Horst Seehofer.

“Kjo do të kufizojë sa më shumë të jetë e mundur të gjitha rreziqet, teknike dhe jo-teknike”, paralajmëroi ai.

# Ç'mund të mësojmë ende nga Revolucioni Francez?

NGA JEREMY POPKIN

**N**ëse Revolucioni Francez i vitit 1789 ishte një ngjarje kaq e rëndësishme, vizitorët në kryeqytetin francez, Paris, pyesin shpesh veten se përse nuk mund të gjejnë asnjë gjurmë të Bastijës, kështjellës mesjetare, sulmi mbi të cilën më 14 korrik 1789, ishte momenti më dramatik i revolucionit?

Të vendosur për të shkatërruar atë që ata e panë si një simbol të tiranisë, “fitimtarët e Bastijës” nisën menjëherë shkatërrimin e godinës. Edhe kolona që është e ngritur në mes të vendit të quajtur “Place de la Bastille”, nuk ka lidhje me 1789-ën, ajo përkujton ata që vdiqën në një kryengritje tjetër, një gjeneratë më vonë, Revolucionin e Korrikut 1830.

Trashëgimia e Revolucionit Francez, nuk gjendet në monumentet fizike, por në ideale të lirisë, barazisë dhe drejtësisë, që frymëzojnë akoma demokracitë moderne. Më ambiciozë se revolucionarët amerikanë të vitit 1776, francezët në vitin 1789 nuk qenë duke luftuar vetëm për pavarësinë e tyre kombëtare, ata donin të krijonin parime, që do të hidhnin bazën e lirisë së qenieve njerëzore kudo në botë.

Deklarata e Pavarësisë e Shteteve të Bashkuara, përmendi shkurtimisht të drejtat e njeriut për “liri, barazi dhe ndjekjen e lumturisë”, pa sqaruar se çfarë synonin, ose si do të realizoheshin ato. Ndërkohë deklarata franceze e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit, shpalosi të drejtat që përfshinin lirinë dhe barazinë, dhe flisnin për një sistem të qeverisjes pjesëmarrëse, që do t'i fuqizonte qytetarët të mbronin të drejtat e tyre.

Shumë më hapur se sa amerikanët, revolucionarët francezë e pranuan se parimet e lirisë dhe barazisë që ata kishin artikulluar, shtronin pyetje themelore në lidhje me çështje të tilla si: statusi i grave dhe skllavëria. Një ligj për ripërkufizimin e martesës dhe legalizimin e divorcit në vitin 1792, u dha grave të drejta të barabarta për të paditur palën tjetër për ndarje, dhe për kujdestarinë e fëmijëve.

Në atë kohë, gratë krijuan klubet e tyre politike, dhe disa prej tyre nisën të shërbejnë në rradhët e ushtrisë franceze. Gratë nisën të kenë aq shumë ndikim në rrugët e Parisit revolucionar, sa që i detyruan ligjvënësit burra të përpiqeshin t'i përjashtonin ato nga aktivitetet e tyre.

Gati në të njëjtën kohë, në vitin 1794, e përballur me një kryengritje të madhe të zezakëve të robëruar në koloninë më të vlefshme franceze në Karaibe, Shën Dominik, Konventa Kombëtare e anuloi skllavërinë, dhe i bëri qytetarë me të drejta të plota viktimat e saj.

Nismat e Revolucionit Francez mbi të drejtat e grave dhe heqjen e skllavërisë, janë vetëm 2 nga shembujt se si revolucionarët francezë eksperimentuan me idetë e reja radikale në lidhje me kuptimin e lirisë dhe barazisë, të cilat janë ende të rëndësishme.



Revolucionarët francezë, ishin të parët që i dhanë të drejtën e votës të gjithë burrave në moshë madhore. Por gjithashtu, ata ishin të parët që u përballën me anën e errët të demokracisë, populizmin demagogjik, dhe me efektet e lulëzimit të mediave të reja, të cilat e transformuan komunikimin politik.

Revolucioni pa përpjekjen e parë në shkallë të plotë për të imponuar ide laike, përballë kundërshtimit të zëshëm të qytetarëve që e shpallën veten mbrojtës të fesë. Në vitin 1792, Franca revolucionare u bë demokracia e parë që nisi një luftë për të përhapur vlerat e saj.

Një pasojë kryesore e asaj lufte, ishte vendosja e diktaturës së parë moderne totalitare, sundimi i Komitetit të Sigurisë Publike gjatë Mbretërimit të Terrorit. Pesë vjet pas përfundimit të tij, Napoleon Bonaparti, që ishte bërë i famshëm gjatë luftës, drejtoi të parin grusht shteti të epokës moderne, duke pretenduar, si shumë liderë autoritarë pas tij, se vetëm një regjim autoritar mund të garantonte rendin shoqëror në vend.

Napoleoni anuloi zgjedhjet, i dha fund lirisë së shtypit dhe rivendosi statusin publik të Kishës Katolike. I vendosur për të mbajtur dhe madje për të zgjeruar pushtimet e huaja të revolucionarëve, ai vazhdoi luftërat që ata kishin nisur. Por tanimë ushtritë franceze luftuan për të krijuar një perandori, duke hedhur çdo pretendim të sjelljes së lirisë tek popujt e tjerë.

Nëse rënia e Bastijës mbetet një simbol i aspiratave për liri, simboli tjetër i njohur botërisht i Revolucionit Francez, gjyotina, na kujton se lëvizja u karakterizua edhe nga dhuna. Është e vështirë të shmangësh përfundimin se

gjatë revolucionit ekzistonte një marrëdhënie midis radikalizmit të ideve, dhe dhunës që e shoqëroi lëvizjen.

Në librin tim “Revolucioni Francez”, unë i njoh lexuesit me një personazh, Per Dyken, që përfaqësonte impulset më populiste të revolucionit. Ai nuk ishte një person real. Pasi nisi revolucionin, një numër gazetarësh filluan të botojnë pamflete që supozohej se ishin shkruar Per Dyken, ku ata kërkuan që Asambleja Kombëtare të bënte më shumë në dobi të të varfërve.

Ashtu si populistët e sotëm, Per Dyken kishte një program të thjeshtë politik. Elitat që sunduan Francën para 1789, e kishin pasuruar veten e tyre në kurriz të popullit. Ato duhej të detyroheshin të ndanin pushtetin dhe pasurinë e tyre. Kur revolucioni nuk e përmirësoi menjëherë jetën e masave, për Dyken u fajësuan drejtuesit më të moderuar të lëvizjes, duke i akuzuar ata për shfrytëzimin e tij, për përfitime vetjake.

Gazetari më i suksesshëm që shkruante nën këtë pseudonim, Zhan Rene Hebert, nxiti krijimin e një ushtrie revolucionare të kontrolluar nga miqtë e tij, për të frikësuar armiqtë e revolucionit, dhe u duk se ishte në prag të marrjes së kontrollit të qeverisë.

Maksimilian Robespieri dhe kolegët e tij në Komitetin e Sigurisë Publike, u tmerruan. Ata vendosën të përballeshin me Hebert dhe ndjekësit e tij. Duke përdorur taktikat dinake të Per Dyken, ata e akuzuan Hebert për intriga me të huajt dhe aktivitete të tjera të dyshimta. Hebert u rrëzua shpejt, dhe turma që brohoriti dërgimin e tij në gjyotinë në marsin e vitit 1794, ishte më e madhe se në shumë nga ekzekutimet që ai vetë kishte nxitur.

Nga ana tjetër shpjegimi se si Robespieri, mbrojtësi parimor i lirisë dhe barazisë, u bë brenda vetëm pak vitesh avokati kryesor i një sistemi të qeverisjes revolucionare, që i parapriu diktaturave totalitare të shekullit XX, është ndoshta sfida më e madhe në mbrojtjen e trashëgimisë së Revolucionit Francez.

Robespieri nuk ishte i pafajshëm, dhe në muajt e fundit të karrierës së tij të shkurtër politike, ishte vetëm 36 vjeç kur vdiq, përballjet e ngathëta me kolegët e tij, i krijuan një numër të rrezikshëm armiqsh por në dallim nga Per Dyken, Robespieri nuk e përqafoi kurrë dhunën si një synim në vetvete.

Kur radikalët si Hebert, nisën një fushatë për të de-kristianizuar Francën, me synim mbylljen e gojës së atyre që e kundërshtonin lëvizjen për të reformuar Kishën Katolike, dhe shitur pronat e saj për të mirën e revolucionit, Robespieri ri-forcoi pozitën e klerit.

Ai e kuptoi se shumica e popullsisë nuk ishte e gatshme të përqafonte një lëvizje radikale laike, e prirur t'i kthente kishat në “tempuj arsyesh”, duke vendosur shenja në varreza, e duke e quajtur vdekjen “një gjumë të përjetshëm”. Robespieri propozoi në vend të kësaj futjen e një kulti të thjeshtëzuar të “Qenies Supreme”, për të cilin ai mendoi se besimtarët mund të përqafojnë pa braktisur besimin e tyre, tek një fuqi më e lartë, dhe besimin e tyre në pavdekësinë e shpirtit.

Robespieri e dinte që shumë nga kundërshtarët më të egër të revolucionit, ishin të motivuar nga besnikëria ndaj Kishës Katolike. Revolucionin as nuk kishte filluar si një lëvizje antifetare. Përballja e revolucionarëve me Kishën, filloi jo si një debat mbi besimet, por

për shkak të nevojës urgjente për të mbushur arkën e boshatisur të shtetit, realitet që e kishte detyruar vetë mbretin Luigji XVI, të mblidhte për rradhë të parë pas shumë kohësh, një asamble kombëtare.

Shumë klerikë katolikë, të cilët kundërshtonin luksin në të cilin jetonin peshkopët e tyre aristokratë, e mbështetën shpronësimin e pronës së kishës, dhe idenë që qeveria kishte të drejtën ta reformonte atë, por të tjerët e panë reformimin e kishës, si një shprehje për një fushatë të frymëzuar nga Iluminizmi kundër besimit të tyre, dhe shumica e popullsisë laike i mbështeti ata.

Në një rajon të Francës, fshatarët formuan një “Ushtri Katolike dhe Mbretërore”, dhe u rebeluan kundër revolucionit që supozohej se ishte kryer për dobinë e tyre. Për përkrahësit e revolucionit, kjo kundërvënie fetare e lëvizjes së tyre u duk si një komplot mbarëkombëtar që parandalonte progresin. Megjithatë politika toksike e fazës më radikale, ndikoi shumë për ta diskredituar revolucionin “Mbretërimi i Terrorit”, që zgjati pak më shumë se një vit, ishte gjithashtu një periudhë e eksperimenteve të rëndësishme në demokraci. Ndërsa mijëra burra dhe gra u burgosën padrejtësisht, mijëra të tjerë mbajtën për herë të parë poste publike.

E njëjta asamble revolucionare që mbështeti Robespierin dhe Komitetin e Sigurisë Publike, hodhi hapat e parë drejt krijimit të një sistemi modern të mirëqenies sociale, dhe miratoi ndër-kohë planet për një sistem gjithëpërfshirës të arsimit publik. Franca revolucionare u bë vendi i parë në botë, që ndërtoi një sistem të rekrutimit ushtarak universal, ku edhe ushtari i zakonshëm nëse e dëshmonte veten të aftë në fushën e betejës, mund të merrte çfarëdolloj grade që meritonte.

Idea se shoqëria kishte nevojë për një klasë të privilegjuar udhëheqësish, në mënyrë që të funksiononte, u sfidua si kurrë më parë. Në mesin e burrave me prejardhje modeste, që u ngritën në pozicione që s' mund t'i kishin arritur kurrë para vitit 1789, ishte një oficer i ri i artilerisë: korsikani Napoleon Bonaparti. Me gjithë dhunën dhe kontradiktat e tij, Revolucioni Francez mbetet kuptimplotë edhe sot për ne. Ta injorosh ose të refuzosh trashëgiminë e thirrjeve të tij për liri dhe barazi, do të thotë të legjitimosh ideologjitë autoritare, ose argumentet mbi pabarazinë e qenësishme të grupeve të caktuara të njerëzve.

Në rast se duam të jetojmë në një botë të karakterizuar nga respektimi i të drejtave themelore individuale, ne duhet të mësojmë leksionet pozitive dhe negative, të përpjekjes së madhe për t'i promovuar ato ideale që rrëzuan Fortesën e Bastijës në vitin 1789.

Marrë me shkurtime nga “Aeon.co”

# Çfarë i kërkoi sulltan Mehmeti Skënderbeut!

## Përse nuk pranoi ta takonte Gjergj Kastrioti Sulltan Mehmetin

*Gjergj Kastrioti: Për dy kërkesat e para nuk jam dakort, për të tretën po. Në Konstandinopojë nuk do të vij sepse më duhet të drejtoi këtë komb krenar shqiptar, të zjarrtë dhe të pathyeshëm*

**Gjergj Kastrioti  
Skënderbeu  
dhe Sulltan Mehmeti**

Në librin e autorit francez, Camille Paganel, me titullin "Histoire de Scanderbeg ou Turcs et Chrétiens au XV siècle", të vitit 1855, gjejmë një letërkëmbim diplomatik ndërmjet sulltan Mehmetit dhe heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit. Sulltani, në pamundësi të mposhtë "vëllain" e tij, ashtu siç i thur lajka në letër, i propozon disa kushte në këmbim të paqes. Gjergj Kastrioti me zgjuarsi dhe kurajo, duke mos dyshuar aspak në dinakërinë e Mehmetit, i kthen atij përgjigjen e merituar, madje duke e trajtuar atë si princ dhe jo si sulltan dhe emir. Letrat, të përkthyer më poshtë në gjuhën shqipe, gjenden në faqet 302-305 të librit, i shkruajtur në gjuhën frënge. Burimi: gallica.bnf.fr/Bibliothèque nationale de France.

**Letra e Sulltan Mehmetit,  
6 maj 1461**

"Unë, Sovrani i madh, Emiri i madh, Sulltan Mehmet Beu, i biri i Sovranit dhe Emirit të madh, Sulltan Murat Beu-t, për Skënderbeun, princin e Shqiptarëve dhe të Epiriotëve, përshëndetje. I shtrenjtë Skënderbe, nuk njoh miqësi më të përzemërt se sa ajo e intimitetit (familjaritetit) të gjatë, sidomos kur ajo lind që në rini, si në rastin tonë, atëherë kur ti mbaheshe peng tek babai im, dhe kur të dy jetonim bashkë vëllazërisht. Kështu, kur mendoj për gëzimet e ëmbla të fëmijërisë sonë, kur kujtoj shkëlqesinë e shërbimeve tuaja, gjithçka që ti ke bërë për lavdinë e Pallatit Osman, për madhështinë e Perandorisë sonë, të të pres dhe të dëshmoj këtë mirënjohje më duket një detyrë e domosdoshme. Asgjë nuk mund të më sjellë më shumë kënaqësi, marrë Zotin për dëshmitar, se sa të ritakoj më në fund, për të kaluar ca kohë në praninë tënde.

Nëse disa prej trupave të mia i kanë lejuar vetes të pushtojnë tokat tuaja duke shkaktuar përleshje, i abdikoj ato; ato kanë vepruar pa urdhërin tim, dhe fitoret tuaja, ndëshkim i drejtë ndaj guximit të tyre, nuk më kanë inatosur. Le ti harrojmë këto dhe të kthehemi në marrëdhëniet tona të vjetra, ku një bashkim i shenjtë dhe paqësor na pajton përgjithmonë. Pra, ja se cilat mund të jenë bazat e aleancës sonë, po ti paraqes, duke e ditur fare mirë



**Gjergj Kastrioti - Skënderbeu dhe Sulltan Mehmeti**

se nuk i përket aspak atij që kërkon paqen të vendosë kushtet.

Së pari, unë kërkoi lejkalim në tokat tuaja për trupat e mia, që të shkojnë për të luftuar venedikasit, së dyti, që ti të më japësh si peng, Gjonin, djalin tënd, i cili do të trajtohet si djali im;

së treti dhe së fundmi, që popujt tanë të tregtojnë lirisht mes tyre.

Në qoftë se ti pranon, eja të më takosh në sigurinë më të plotë: pritja do të jetë dinjitoze e rangut tuaj. Po, mbi besën dhe fjalën e sovranit, do të mbaj besnikërisht me ty një paqe të pacënueshme, tashmë vendi yt nuk do të shqetësohet as nga armët e mia, as nga dikush tjetër. Për më shumë, në qoftë se ke pyetje apo dyshime për të sqaruar, mund ti drejtohesh me besimin më të plotë, Mustafait, të dërguarit tim".

Letër e shkruar në qytetin tonë perandorak të Konstandinopojës, më 6 maj të vitit 1461.

### Letra e Gjergj Kastriotit, 1 qershor 1461

"Gjergj Kastrioti, i thirrur Skënderbe, princ i Epiriotëve dhe i Shqiptarëve, ushtar i Jezu Krishtit, për Mehmetin, sovranin e Turqve, përshëndetje.

Princ i dalluar, ne e kemi marrë letrën ku dallohen përshpjetet e miqësisë tënde. Të ndarë prej shumë kohësh nga njëri-tjetri, kjo miqësi reciproke, e thënë nga ti, ishte si e përgjumur, dhe ti dëshiron ta zgjosh atë nëpërmjet një aleance intime (të ngushtë).

E pranoj propozimin tënd me kënaqësi, por jo të gjitha kushtet.

Kështu, aleat dhe mik i venedikasve, nuk mundem, pa shkelur mbi betimin dhe dinjitetin tim, të të jap lejkalim për t'i

sulmuar.

Përse i përket dhënies peng të djalit tim, për ta pasur atë si nyje të një lidhje të re mes nesh, zemra e një babai dhe një nëne nuk mund të përballojë një sakrificë të tillë. Është fëmija i vetëm që Zoti na ka dhuruar, dhe është akoma i mitur! Përveç kësaj, do t'i shkaktohej një dëm i pariparueshëm nëse nuk rritet me zakonet dhe fenë e vendit të tij.

Tani, mbetet çështja në lidhje me tregtinë e lirë mes dy vendeve, këtë, i gjithë Këshilli im dhe unë e mbështesim plotësisht, sepse të dy kombet gjejnë një përfitim të barabartë.

Ti më fton për vizitë, me

besimin më të plotë, për të përforcuar mes palëve një miqësi prej kohësh në vuajtje: falenderime princ i shkëlqyer për mirësinë tënde. Fatkeqësisht për mua, ky udhëtim në Konstandinopojë, i cili më sjell ndër mend shumë kujtime, nuk është i mundur ngaqë përku-jdesem për qeverinë time, sepse po të vij, nuk mund të drejtoj si duhet këtë komb krenar shqiptar po aq të zjarrtë dhe të pathyeshëm, sa dhe të padurueshëm për pushim (paqe).

Por këtë vizitë e shtyjmë për një herë tjetër, do të mundohem kur të jetë e mundur".

Nga ana jonë, 1 qershor 1461.



# **“Mbytet” në Dhërmi anija ushtarake “Polumbarja Kineze”, shndërrohet në një atraksion turistik**

